



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 08/41 Prot.

Tiranë më, 15/04/2023

V E N D I M

Nr. 24 datë 15.04.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Denisa Sina	Kryesues
Suela Bulku	Relator
Arben Sefaj	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ledjana Azemaj, më datë 12.04.2024, ora 14:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Rebani Kaso Jaupi, me funksion Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, Znj. Suela Bulku, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Z. Rebani Jaupi, i cili në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, **Z. Rebani Jaupi** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si “Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike”
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Rebani Jaupi**, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. ** datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit, e përbërë nga: Znj. Suela Bulku (Relatore), Znj. Denisa Sina (Kryesuese) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. ** datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Rebani Jaupi**.
6. Relatori i çështjes, Znj. Suela Bulku, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar,

dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Më datë 19.04.2023, në zbatim të nenit 33/1, nenit 42 dhe nenit 46, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit, pranë institucioneve ndihmëse, e konkretisht:
 - ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.
 - ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 19.04.2023, është dërguar formulari i deklaramit të kontrollit të figures, pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
8. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, në datën 19.04.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ Vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ Kontrollin e figurës;
 - ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”

- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë, 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ✚ Deklarata e Pasurisë,
- ✚ Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- ✚ Formulari i Vlerësimit Profesional
- ✚ Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- ✚ Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- ✚ provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- ✚ ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 09.04.2024, pasi dëgjoji relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Rebani Jaupi, me Vendimin nr. ** datë 09.04.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Rebani Kaso Jaupi**;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - ✚ Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të

Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
15. Në datën 11.04.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 12.04.2024, në orën 14:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Rebani Jaupi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 12.04.2024, subjekti i vlerësimi z. Rebani Jaupi, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 15.04.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Subjekti i vlerësimit z. Rebani Jaupi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur ka qenë e nevojshme, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Rebani Jaupi**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. ** indexi, viti 2023.

- ✚ Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- ✚ Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raportin nr. ***, datë 06.11.2024, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Rehani Jaupi, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

Rebani Jaupi, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2004, me numër indeksi 2412 dhe sipas deklarimit online me numër indeksi 2462. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2004
- Periodike/Vjetore 2004
- Periodike/Vjetore 2005
- Pas largimit nga funksioni 2006
- Para fillimit të detyrës 2014
- Periodike/Vjetore 2014
- Periodike/Vjetore 2015
- Periodike/Vjetore 2016
- Periodike/Vjetore 2017
- Periodike/Vjetore 2018
- Periodike/Vjetore 2019
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- REBANI JAUPI

DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

1. Truall, regjistruar në datë 12.04.2017, numër pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë, sip. 638 m2, blerë në vitin 1996. Burimi i krijimit, nga të ardhurat e familjes ndër vite, si dhe të vëllezërve të mi të cilët janë dhe bashkëpronarë në këtë pronë. Shuma e paguar nga ana ime është 178.000 lekë, në vitin 2011 dhe 2000 Usd në vitin 1996. Vlera 1.134.000 lekë. Zotëron 33.3 %.

1.1 Godinë banimi, regjistruar në datë 12.04.2017, numër pasurie ***, zk. ***, ZVRPP Tiranë. Shtëpi banimi me sipërfaqe totale 822 m2, e ndërtuar mbi truallin prej 638 m2, në Njësinë Bashkiake nr. 5, rruga “****”, nr. ***. Sipërfaqja e banimit që më përket mua është 254 m2, ku përfshihen 78 m2 kati i parë, 90 m2 kati i dytë, 85.4 m2 kati i tretë dhe 42 m2 garazh. Në këtë sipërfaqe është përfshirë sipërfaqja e shkallëve dhe e ballkoneve. Burimi i krijimit: kjo godinë është ndërtuar në vitet 1995 - 2000 me kontributin e vëllezërve të mi Sh.J dhe S.J. Kontributi

im në këtë objekt është 800.000 lekë, i cili ka shërbyer për arredim. Vlera 4.126.000 lekë. Zotëron 33.3 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kartelë pasurie, datë 12.04.2017, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 638 m2, ndërtesë 274 m2, e ndodhur në Tiranë, në emër të S.J, Rebani Jaupi dhe S.J. Pasuria ka shënimin "Leje legalizimi nr. ***, dt. 16.2.2017, sip. kt. nëntokë 158.8 m2, kt. përdhe 274 m2, verandë + shkallë 36 m2, banimi 310 m2, kati i parë 280 m2, verandë 28.6 m2, banimi 309.4 m2, kt. i dytë 202 m2, banimi 202 m2 dhe verandë 102.4 m2". Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.7.2003, me palë shitëse 19 bashkëpronarë, kryesisht me mbiemër "****", dhe blerës Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, me sip. 210 m2, e ndodhur në Tiranë, Selitë, në vlerën 500.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerie nr. *** rep. nr. *** kol, datë 20.11.2003, me palë shitëse B.P dhe blerës Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, me sip. 250 m2, e ndodhur në Tiranë, Selitë, në vlerën 100.000 lekë, likuiduar plotësisht. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 18.07.2011, me palë shitëse B.P dhe S.P, dhe blerës Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit truall, me nr. ***, me sip. 178 m2, e ndodhur në Tiranë, rruga "****", në vlerën 534.000 lekë, e likuiduar në pjesë të barabarta nga blerësit para lidhjes së kontratës. De facto trualli është blerë që në vitin 1995, me çmimin e atij viti. Bashkëlidhur praktika.
- Leje legalizimi nr. ***, datë 16.02.2017, për objektin godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, i jepet shtetasve Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, me adresë "****", Tiranë, pasuria me nr. ***, zk. ***. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore 313.9 m2, sipërfaqja e ndërtimit 274 m2, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 980.2 m2, sipërfaqe verande 102.4 m2. Bashkëlidhur praktika.
- Raport Vlerësimi, datë 10.02.2021, nga inxhinier ndërtimi E.S dhe vlerësues L.V, për truall me sip. 638 m2, brënda të cilit ndodhet një objekt me sip. 654 m2, ndodhur në rrugën "****", Tiranë. Prona u inspektua në shkurt 2021 dhe vlerësimi u përgatit në dt. 10.02.2021. Ky vlerësim është kryer mbi referencat e ndërtimit të objektit, bazuar në ligjet dhe manualin e vitit 1992, pasi objekti është ndërtuar në vitin 1995. Ndërtesa është 3 kate, me sipërfaqe totale 654.4 m2, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi. Vlera e kostos së objektit të ndërtuar në vitin 1995 është 4.184.744 lekë. Bashkëlidhur analiza teknike e çmimeve, në formë tabele.

Hetimi Administrativ

- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore, Tiranë, Jug**, me shkresën nr. *** prot., datë 26.06.2023, konfirmon në emër të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit truall me sip. 638 m2, nga e cila ndërtesë 274 m2. Pasuria ka shënimin tek kartela e pasurisë "Leje legalizimi nr. ***, datë 16.02.2017, sip. kt. nëntokë 158.8 m2, kati përdhe 274 m2, verandë + shkallë 36 m2, banimi 310 m2, kati i parë 280 m2, verandë 28.6 m2, banimi 309.4 m2, kati i dytë 202 m2, banimi 202 m2 dhe verandë 102.4 m2". Bashkëlidhur praktika.

Konfirmon se Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, janë vetëdeklarues me nr. *** prot, datë 21.03.2005, për objektin e ndodhur në “****”. Subjekti është pajisur me leje legalizimi, datë 16.02.2017, për objektin "Godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntoke", me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 313.9 m2, sipërfaqe ndërtimi 274 m2, sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 980.2 m2, sipërfaqe verandë 102.4 m2. Bashkëlidhur praktika, si dhe dokumentacioni si më poshtë:

- Leje legalizimi nr. ***, datë 16.02.2017, për objektin godinë banimi 3 kate + 1 kat nëntokë, i jepet shtetasve Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, me adresë, “****”, Tiranë, pasuria me nr. ***, zk. ***. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore 313.9 m2, sipërfaqja e ndërtimit 274 m2, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 980.2 m2, sipërfaqe verande 102.4 m2. Trualli i pronësisë mbi tokën, vërtetohet me dokumentat e kartelave të pasurive me nr. ***, *** dhe ***.
- Vetëdeklarim për legalizim, datë 21.03.2005, nga deklaruesit Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, adresa “****”, viti i ndërtimit 30.04.1995, objekt 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, rruga Komuna e Parisit, zbatues Shkëlqim Jaupi, sipërfaqja e ndërtimit 274 m2.
- Procesverbal verifikimi në terren, viti 2016, për banesë 3 kate, me 1 kat nëntokë, në posedim të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 313.9 m2, ndërtimi me sipërfaqe totale 980 m2, sip. verande 102.4 m2, kati nëntokë 158.8 m2, kati përdhe 310 m2, kati i parë 309.4 m2 dhe kati i dytë 202 m2.
- Planimetri të ndarjeve të pjesëve takuese, të vulosura nga ASHK, viti 2016, të objektit të ndërtuar në rrugën “****”, Tiranë, në emër të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, ku rezulton se Rebani Jaupi, ka të ndara sipas planimetrive, në total, një sipërfaqe prej 296.6 m2, Sami Jaupi 443 m2 dhe Shkëlqim Jaupi 343 m2.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se trualli me nr. pasurie ***, zk. ***, Tiranë, me sip. 638 m2, është blerë de facto rreth vitit 1995 - 1996, nga vëllezërit e tij S.J, dhe S.J, në dakortësi me palët shitëse. Kontributi i tij në vlerë monetare për blerjen e truallit ka qënë në vlerën 2.000 USD, në vitin 1996 dhe 178.000 lekë, në vitin 2011, pagesa këto të dhëna cash vëllezërve të tij, me burim të ardhurat familjare. Në lidhje me vlerën e blerjes së kësaj pasurie thekson se blerja ka filluar nga viti 1995 dhe në atë kohë ajo ka qënë vlere e tregut. Pavarësisht datave kur janë përpiluar kontratat e shitblerjes, sic e ka theksuar më lart, kjo pasuri është blerë nga viti 1995, por kur u regjistrua prona në emër të pronarëve, u bë më pas edhe shitja e tyre me kontratat respektive. Një nga kontratat shprehet mbi faktin, që de facto trualli është blerë që në vitin 1995, me çmimin e atij viti.
- Në lidhje me godinën e banimit, regjistruar në datën 12.04.2017, me sipërfaqe totale 980 m2 dhe verandë, e ndërtuar mbi truallin prej 638 m2, në rrugën “****”, godina në të cilën banojnë, sqaron se është ndërtuar me kontributin e vëllezërve, S.J, dhe S.J, sepse në këtë periudhë ata kishin kompaninë e tyre ndërtuese “****” shpk, në të cilën ishin ortakë. Ndërtimi ka filluar nga viti 1995 deri rreth vitit 2000. Shoqëria “****”, është krijuar në vitin 1994, me objekt veprimtarie ndërtimi, projektimi, ndërtime civile dhe shitje e materialeve ndërtimore. Burimi i të ardhurave, që mundësoi dhe ndërtimin e objektit, ka ardhur nga aktiviteti i biznesit të vëllezërve të tij, si dhe shitja e apartamenteve në qytetin e Tepelenës nga vëllezërit. Në përfundim të ndërtimit të këtij objekti, ai u nda në tre pjesë fizike, ku sipërfaqja e banimit që i përket subjektit, është rreth 295 m2. Në deklarimin e tij, ku shprehet që kjo sipërfaqe është 254 m2, sqaron se mund të jetë një lapsus në llogaritje të metrave.

- Subjekti sqaroi se ai ka kontribut vetëm në pagesën për blerjen e truallit, ndërsa ndërtimi i godinës është kryer nga kontributi i vëllezërve të tij, duke qënë se ata kishin firmë ndërtimi dhe mundësi financiare më shumë se subjekti, por pavarësisht kësaj ata e kanë njohur si bashkëpronar në pjesë të barabarta, me nga 1/3 pjesë takuese secili, duke qënë se janë vëllezër dhe donin të jetonin në një godinë së bashku.
- Subjekti sqaroi se ka shpenzuar për arredimin dhe sistemimin e pjesës së brendshme të tij, shumën rreth 800.000 lekë, gjatë periudhës deri në vitin 2005, me burim nga të ardhurat familjare. Nuk disponon fatura duke qënë se mobiljet dhe pajisjet elektroshtëpiake janë blerë në periudha të ndryshme dhe faturat janë ruajtur deri në periudhën e garancisë nga dyqanet ku janë bërë blerjet.
- Në lidhje me sipërfaqen e objektit të deklaruar prej 822 m², i cili në lejen e legalizimit rezulton me sipërfaqje 980 m dhe verandë rreth 100 m², sqaron se sipërfaqja prej 822 m², e deklaruar prej tij, i referohet sipërfaqes së njollës të të gjithë objektit, pa përfshirë katin nëntokë rreth 158 m². Ndërkohë, përse i përket sipërfaqes takuese, thekson se sipërfaqja takuese faktike, nuk i korrespondon saktësisht 33.3 %, sepse nga matjet e legalizimit, ka më pak metra katror se vëllezërit. Pra pjesa e ngelur pas zbritjes së sipërfaqes, i përket vëllezërve të tij, duke përfshirë këtu edhe një shtesë anësore, që nuk i përket kësaj njolle, prej 68 m², të bërë nga vëllai S.J
- Në lidhje me raportin e vlerësimit të përpiluar në vitin 2021, ku shprehet se objekti ka një sipërfaqe prej 654 m², sqaron se do jetë bërë lapsus në llogaritjen e metrave të objektit nga ana e vlerësuesit, pasi ky objekt është i legalizuar që në vitin 2017 dhe ka një sipërfaqe totale prej rreth 980 m² dhe 100 m² verandë dhe kjo është e evidentueshme nga dokumentacioni përkatës.

Me inventarin e datës 06.11.2023, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 04.11.2023, me palë deklaruese Sh.J dhe S.J, të cilët deklarojnë, se bashkë me vëllain e tyre Rebani Jaupi janë bashkëpronarë, në godinën e banimit me siperfaqe rreth 980 m², të ndërtuar në truallin me sip. 638 m², me nga 1/3 pjesë takuese secili, në godinën e banimit dhe në truall. Vlera e truallit të blerë nga të tre vëllezërit është 1.134.000 lekë, bazuar në kontratat respektive të blerjes dhe vlera e godinës së banimit, e cila është ndërtuar rreth viteve 1995 deri në vitin 2000, në total ka kushtuar rreth 4.126.000 lekë. Vlera e paguar nga vëllai i tyre Rebani Jaupi, për truallin, është 2.000 USD, në vitin 1996 dhe 178.000 lekë, në vitin 2011, pagesa këto të marra cash. Kjo pasuri de facto është blerë nga ana e deklaruesve Sh.J dhe S.J, që në vitet 1995 deri 1996, në dakortësi me pronarët e truallit, por duke qënë se ata nuk kishin pronën të regjistruar në emër të tyre, u prit deri në momentin që pronarët u pajisën me dokumentacionin përkatës dhe më pas u përpiluan kontratat e shitjes. Pjesa tjetër e blerjes së truallit dhe ndërtimit të godinës është paguar nga ana e deklaruesve Sh.J dhe S.J, pasi ata kishin aktivitet privat në fushën e ndërtimit gjatë asaj periudhe, si dhe mundësi financiare më të shumta se vëllai i tyre Rebani Jaupi. Si burim, përveç biznesit, deklarojnë se ka shërbyer edhe shitja e banesave të tyre në qytetin e Tepelenës. Në këto kushte pavarësisht vlerës së paguar nga vëllai Rebani Jaupi, ata e kanë njohur si bashkëpronar në pjesë të barabarta, me nga 1/3 pjesë takuese secili, duke qënë se janë vëllezër dhe donin të jetonin në një godinë së bashku. Palët deklarojnë se nuk kanë detyrime apo pretendime për këtë pasuri.

- Genplan i objektit 3 kate + 1 kat nëntokë, datë 23.12.2016, sipërfaqja bazë e ndërtimit 274 m², në emër të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi. Bashkëlidhur planimetria e katit të parë, ku evidentohet edhe një shtesë anësore.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 03.08.1994, për regjistrimin e personit juridik, me palë kërkuese Sh.J dhe S.J, të cilët kërkojnë të regjistrojnë shoqërinë “****” shpk si person juridik, me objekt veprimtarinë në fushën e ndërtimit, studimit, projektimit, ndërtime civile, industriale etj.
- Kontratë shitje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 05.04.1998, me palë shitëse Sh.J dhe blerës Sh.D, për apartament ndodhur në Tepelenë, në vlerën 700.000 lekë.
- Kontratë noteriale shitje, (pjesërisht e qartë), e vitit 1996, me palë shitëse S.J dhe P.J dhe blerës H.Z dhe E.Z, për apartament në qytetin e Tepelenës, në vlerën 2.200.000 lekë.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se;

Pasuria godinë me sip. totale 980 m² + 102.4 m² verandë, në truall me sip. 638 m², në Rr. “****”, Tiranë, është ndërtuar deri në vitin 2000, me vlerë të deklaruar dhe të dokumentuar rreth 4.126.000 lekë, me burim të ardhura të vëllezërve Sh.J dhe S.J, nga aktiviteti privat i shoqërisë së ndërtimit “****” shpk, si dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të tyre në qytetin e Tepelenës, në shumën 2.900.000 lekë.

Trualli është blerë rreth viteve 1995 - 1996, në vlerën totale 1.134.000 lekë (me kontribut të subjektit në shumën 2.000 USD + 178.000 lekë), formalizuar me kontratat e shitblerjes në vitin 2003 - 2011. Sipas deklarimit të subjektit dhe deklaratës së vëllezërve, rezultojnë se subjekti Rebani Jaupi, për pasuritë e mësipërme, ka paguar në total 2.000 USD në vitin 1996 dhe 178.000 lekë në vitin 2011, si dhe ka shpenzuar 800.000 lekë, për arredimin e pjesës së tij, deri në vitin 2005.

- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, në lidhje me pasurinë truall me sip. 638 m², mbi të cilin është ndërtuar objekt me sip. 980 m² ndërtesë + 102.4 m² verandë, në Rr. “****”, Tiranë, ku subjekti është bashkëpronar sëbashku me vëllezërit e tij.**
- ✓ **ASHK konfirmon në emër të subjektit truallin me sip. 638 m², me pjesë takuese 1/3 dhe 296.6 m² sipërfaqe ndërtimi, në godinën e ndërtuar mbi këtë truall.**
- ✓ **Shpenzime për mobilim shtëpie deklaruar rreth 800.000 lekë.**

2. **Ullishte**, regjistruar në datë 12.04.2004, numër pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë, blerë në vitin 2004.
 - Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 31.01.2004. Blerë nga unë në bashkëpronësi me vëllezërit e mi Sh.J dhe S.J, me sip. 2.300 m², në shumën 500.000 lekë.
 - Kontratë shitblerje nr. *** rep. *** kol, datë 17.11.2006, blerë nga ana ime dhe vëllait Sh.J, me sip. 500 m², në shumën 500.000 lekë.
 - Kontratë shitje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.10.2010, blerë nga unë dhe vëllezërit e mi Sh.J dhe S.J, me sip. 200 m², në shumën 78.400 lekë.

- Burimi i krijimit, kursimet familjare ndër vite, të mijat dhe të vëllezërve të mi Sh.J dhe S.J, shuma 1.078.400 lekë. Vlera e likuiduar për këtë pronë nga ana ime është 359.800 lekë.
- Për këtë pronë është lidhur kontratë sipërmarrje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 21.08.2018, midis sipërmarrësit “****” shpk dhe Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, në cilësinë e palës porositëse (pronar të truallit). Me vendimin nr. ***, të Bashkisë Tiranë, datë 02.09.2020, është miratuar leja e ndërtimit për godinë banimi 3, 4 dhe 5 kate, me 3 kate parkim nëntokë, me zhvillues shoqërinë e sipërcituar.
- Nga kjo kontratë sipërmarrje, unë dhe vëllezërit e mi, në total, përfitojmë 30 % të të gjithë sipërfaqeve të ndërtuara, mbi dhe nëntokë. Në total unë përfitoj 5 apartamente me sipërfaqe totale neto 458.46 m2, 4 vende parkimi me sipërfaqe totale neto 80.88 m2, 1 studio në katin - 3, me sipërfaqe totale 37.03 m2, ambjent i përbashkët me dy vëllezërit e mi. Vlera 1.078.400 lekë. Zotëron 33.3 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Urdhër nga ZVRPP Tiranë, nr. ***, datë 29.04.2011, ku shtetasi K.C, (përfaqësues me prokurë), kërkon të saktësojë pronat e ndodhura në Selitë, Tiranë, në bazë të deklaratës noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 28.12.2010, ndër të tjera edhe pasuritë si më poshtë:
 - Pasuria nr. ***, me sip. 2.300 m2, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi.
 - Pasuria nr. ***, me sip. 500 m2, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi.
 - Pasuria nr. ***, me sip. 200 m2, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi.
- Në përfundim është vendosur që të bëhet bashkimi i pasurive të mësipërme dhe të hapet kartelë e re për pasurinë nr. ***, me sip. 3.000 m2, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi.
- Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep. nr. *** kol, datë 31.01.2004, me palë shitëse Xh.H, N.H, A.H dhe G.H, dhe blerës Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit ullishte, me nr. ***, me sip. 2.300 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në vlerën 500.000 lekë. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 17.11.2006, me palë shitëse R.A dhe H.Q, dhe blerës Sh.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit ullishte, me nr. ***, me sip. 500 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë. Shitësit zotërojnë 2/3 pjesë takuese të kësaj pasurie dhe këtë pjesë i'a shesin blerësve në vlerën 500.000 lekë. Me shitjen më sipër deklarojnë se janë dakort edhe bashkëshortët e shitësve, si dhe bashkëpronari tjetër S.J. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shirblerje pasuri e paluajtshme, nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.12.2010, me palë shitëse Xh.H dhe N.H dhe blerës Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit ullishte, me nr. ***, me sip. 200 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në vlerën 78.400 lekë. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 21.08.2018, me palë porositëse pronare trualli; Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, dhënës pëlqimi P.J, R.J dhe Elvira Jaupi, dhe palë sipërmarrëse investitor shoqëria “****” shpk. Objekti i kësaj kontrate është bashkimi dhe vënia në dispozicion nga pala porositëse, të pasurisë së llojit ullishte, me sip. 3.000 m2, palës sipërmarrëse, me qëllim ndërtimin e një pallati shumëkatësh dhe multifunksional, me ambiente banimi dhe shërbimi. Palët bien dakort që në shkëmbim të kësaj pasurie, porositësit do të përfitojnë 30 % të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit.

- Vendim nga Bashkia Tiranë, nr. ***, datë 25.09.2020, për miratimin e lejes së ndërtimit për godinë banimi 3, 4, dhe 5 kate, me 3 kate parkim nëntokë, në rrugën “****”, në pronësi të Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, me zhvillues shoqëria “****” shpk. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shtesë e sip. për pjesët (pronë, truall firmë ndërtimi), nr. *** rep. nr. *** kol, datë 29.06.2021, me palë investitore shoqëria “****” shpk dhe palë porositëse pronare trualli; Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi, dhënës pëlqimi P.J, R.J dhe Elvira Jaupi. Palët mes tyre kanë lidhur një kontratë sipërmarrje me nr. *** rep. nr. *** kol, datë 21.08.2018. Për sipërfaqet në katin -3, -2 dhe -1, shtetasi Rebani Jaupi do të përfitoj në total, 4 parkime (nr. 2, 19, 33 dhe 39) me sipërfaqe totale bruto 232.06 m2. Shtetasit P.J, R.J dhe Elvira Jaupi, përfitojnë në bashkëpronësi, në pjesë të barabarta, studio në katin -3, me sipërfaqe bruto 42.75 m2. Shtetasi Rebani Jaupi, përfiton 5 apartamente (nr. 3, 19, 24, 45 (duplex) dhe 48), me sipërfaqe totale bruto 529 m2 dhe tarracë 100.79 m2. Vlera në para e sipërfaqes së përfituar nga shtetasi Rebani Jaupi, llogaritur në metër katror për secilën njësi ndërtimore, është 751.341 euro. Sipërmarrësi merr përsipër të regjistrojë pranë ASHK, të gjithë dokumentacionin përkatës.

✚ **ASHK, Dreitoria Vendore, Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. *** prot, datë 23.06.2023, konfirmon të regjistruar në emër të P.J, R.J dhe Elvira Jaupi, me nga 1/3 pjesë takuese, pasurinë e llojit Ullishte, me sip. 3.000 m2, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në datën 25.04.2011. Bashkëlidhur praktika.

- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se, në lidhje me vlerën e ullishtes prej 3.000 m2, në total prej 1.078.400 lekë, pjesa më e madhe e kësaj pasurie është blerë që në vitin 2004, me sip. 2.300 m2 dhe më pas në vitin 2006 dhe vitin 2010, është blerë edhe pjesa tjetër prej 700 m2 dhe për këtë arsye vlera e tregut në atë kohë për këtë pasuri ishte ajo e parashikuar në kontratat e shitblerjes.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Pasuria ullishte me sip. 3.000 m2, në Selitë, Tiranë, ku subjekti është bashkëpronar me 1/3 pjesë, është blerë gjatë periudhës 2004 - 2010, në vlerën totale 1.078.400 lekë, me kontribut nga ana e tij në shumën 359.800 lekë, me burim nga të ardhurat familjare. Kjo pasuri në vitin 2018, i është dhënë për ndërtim shoqërisë “****” shpk, ku pala porositëse, pronare e truallit, subjekti dhe vellezërit e tij, kanë përfituar 30% sipërfaqe ndërtimi. Konkretisht, subjekti do të përfitojë 5 apartamente me sip. totale neto 458.46 m2, si dhe 4 vende parkimi me sip. totale neto 80.88 m2. Gjithashtu do përfitojë dhe 1 studio në katin -3, me sip. 37.03 m2, në bashkëpronësi me dy vellezërit.

- ✓ **ASHK konfirmon pasurinë ullishte me sip. 3.000 m2 në bashkëpronësi të subjektit dhe dy vellezërve të tij.**
- ✓ **Subjekti ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me dhënien e truallit për ndërtim shoqërisë “****” shpk, në vitin 2018, si dhe pasuritë që do të përfitohen nga kjo sipërmarrje.**

3. **Njësi me sip. 45 m2**, regjistruar në datë 25.09.2007, numër pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, për blerje njësi në Selitë, në shumën 3.350.000 lekë. Vlera reale e likuiduar nga ana ime është në shumën 2.233.333 lekë. Për pjesën takuese kundrejt vëllait tim S.J, nuk kam detyrim financiar, për faktin se prona është marrë në karabina. Burimi, kursime nga të ardhurat familjare ndër vite, nga paga ime dhe e bashkëshortes, përfshirë nga të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit dhe vëllezërve. Likuidimi total i kësaj njësie referuar vlerës totale të blerjes ka përfunduar në vitin 2020. Vlera 3.350.000 lekë. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 17.08.2007, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 45 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në emër të R.A, H.Q dhe S.J. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, me palë shitëse R.A, H.Q dhe S.J dhe blerës Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 45 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në vlerën 3.350.000 lekë, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale.
- Kartela e pasurisë, datë 15.12.2016, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 45 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në emër të Rebani Jaupi, regjistruar në datën 25.09.2007.

✚ **ASHK, Drejtoria Vendore, Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. *** prot, datë 23.06.2023, konfirmon të regjistruar në emër të Rebani Jaupi, pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit njësi, me sip. 45 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në datë 25.09.2007. Bashkëlidhur praktika.

- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se, njësia me sip. prej 45 m2, përfituar përmes kontratës së shitblerjes, datë 13.09.2007, është në pallatin e ndërtuar nga firma “***” shpk, me investim të tre ortakëve bashkëinvestitorë, R.A, H.Q dhe S.J. Vlera e likuiduar nga ana e tij për këtë pasuri, është në shumën 2.233.333 lekë, paguar ortakëve të vëllait, H.Q dhe R.A, në vitin 2007, nga vlera e përcaktuar në kontratë prej 3.350.000 lekë, pra ka paguar 2/3 e kësaj vlere. Për pjesën takuese të vëllait të tij S.J, në këtë pasuri, nuk është kryer pagesë nga subjekti, pasi kjo pasuri ishte pjesërisht e përfunduar, në pjesën e brendshme të saj, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me vëllain e tij. Subjekti deklaron gjithashtu se për të vërtetuar këtë fakt, në vitin 2007 ka marrë edhe një kredi bankare tek Tirana Bank, në vlerën rreth 20.000 euro, për rikonstruksionin e njërive të blera në vitin 2007. Subjekti deklaron se nuk ka pretendime apo detyrime me vëllain e tij për këtë pasuri, pasi ai ka shlyer detyrimin kundrejt dy ortakëve të tjerë. Si burim për blerjen e kësaj prone kanë shërbyer, kursimet nga të ardhurat familjare ndër vite, si dhe dhurimi i bërë nga mamaja e bashkëshortes, në vitin 2007, në vlerën 50.000 USD, me burim nga aktiviteti privat i vjehrrit B.H, nga shoqëria “***”, deri në vitin 2002, për të cilat mund të disponoj pjesërisht dokumentacion justifikues ligjor përkatës. Në lidhje me faktin që ka deklaruar se likuidimi total i kësaj njësie ka përfunduar në vitin 2020, sqaron se ky deklaram i përket njësisë me sip. 100 m2, blerë nga vëllezërit e tij në vitin 2012, por gabimisht është shprehur edhe në këtë pasuri.

Me inventarin e datës 06.11.2023, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 04.11.2023, me palë R.A, H.Q dhe S.J, të cilët deklarojnë se kanë qënë bashkëinvestitorë, në objektin godinë banimi dhe shërbimi në Selitë, Tiranë, e cila është ndërtuar rreth viteve 2003 - 2007, nga shoqëria “****” shpk, në pronësi të deklaruesve. Ky objekt u regjistrua, pasi ishin paguar të gjitha detyrimet tatimore, sa i takonte investitoreve dhe kompanisë së ndërtimit, sipas çmimeve reference të përcaktuara nga ZRPP. Referuar sa më sipër, palët deklarojnë se në vijim është kryer kontrata e shitjes kundrejt shtetasit Rebani Jaupi, për pasurinë si vijon: Pasuria me nr. ***, me sip. 45 m2, i është shitur shtetasit Rebani Jaupi, sipas kontratës nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, në vlerën totale 3.350.000 lekë. Palët deklarojnë se kjo pronë, në momentin e shitjes nga pala e deklaruesve si investitore ka qënë pjesërisht e përfunduar në pjesën e brendshme të saj. Deklaruesit H.Q dhe R.A, deklarojnë se kanë marrë nga Rebani Jaupi, në vitin 2007, vlerën prej 2.233.333 lekë, për pjesën e tyre takuese, nga vlera totale e kontrates së shitjes së kësaj pasurie. Shtetasi S.J deklaroi se, për pjesën e tij takuese prej 1/3 në këtë pasuri, nuk ka kërkuar pagesë ndaj vëllait të tij Rebani Jaupi, pasi kjo pasuri ishte pjesërisht e përfunduar, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me të. Deklaron se nuk ka pretendime financiare apo detyrime me vëllain e tij për këtë pasuri, pasi ai ka shlyer detyrimin kundrejt dy ortakëve të tjerë.
- Ekstrakt historik i shoqërisë “****” shpk, me Nipt. ***, themeluar në vitin 1999, me objekt "Projektim i strukturave të zakonshme prej murature tulle, betoni, ndërtime civile, industriale etj. ", me ortak dhe administrator shtetasin R.A. Kjo shoqëri rezultoi e regjistruar me vendim të Gjykatës së Tiranës, në vitin 1999, me përfaqësues ligjor dhe ortak shtetasin R.A.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 02.11.2023, me palë deklaruese A.H, e cila deklaroi se në vitin 2007, i ka dhënë vajzës Elvira Hoxha, shumën 50.000 USD, si dhuratë nga kursimet familjare të përfituara nga aktiviteti ekonomik-tragtar i kompanisë “****”, që i përkiste bashkëshortit të saj shtetasit B.H, gjatë viteve 1992 - 2002. Kjo për arsye se vajza është pjesë me një të tretën, sipas deklaratës së trashëgimisë së babait të saj z. B.H, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2002.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1993, firmosur nga pronari B.H, ku rezultoi fitimi neto në vlerën 114.970 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1994, firmosur nga pronari B.H, ku rezultoi fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 222.428 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 137.129 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1995, firmosur nga pronari B.H, ku rezultoi fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 427.940 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 561.560 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1996, firmosur nga pronari B.H, ku rezultoi fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 267.869 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 713.598 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1997, firmosur nga pronari B.H, ku rezultoi fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 733.548 leke.
- Kontratë shitblerje datë 05.11.1993, me shitës shoqëria “****”, me pronar B.H dhe blerës A.T, për traktor tip Biellorus, në vlerën 1.750.000 lekë.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 07.06.1993, me palë shitëse shoqëria “***”, me pronar B.H dhe blerës Sh.B, për traktor tip Biellorus, në vlerën 500.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 17.03.1993, me palë shitëse shoqëria “***”, me pronar B.H dhe blerës A.K, për traktor tip Biellorus, në vlerën 820.000 lekë.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Njësia me sip. 45 m2, me adresë në Selitë, Tiranë, është blerë me kontratën e vitit 2007, me çmim 3.350.000 lekë, nga bashkëinvestitorët R.A, H.Q dhe S.J. Sipas sqarimeve të subjektit për këtë njësi, shuma e paguar nga ana e tij është 2.233.333 lekë, në vitin 2007, ortakëve të vëllait të tij, R.A dhe H.Q. Për pjesën takuese të S.J në këtë pasuri, nuk është kryer pagesë, pasi ishte pjesërisht e përfunduar, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me vëllain e tij.

Në vitin 2007, subjekti ka marrë kredi në shumën 20.000 Euro në Tirana Bank, përdorur për përfundimin e punimeve të kësaj njësie, si dhe për njësinë tjetër në Selitë. (trajtuar tek kredia bankare e deklaruar më poshtë).

- ✓ **ASHK konfirmon pasurinë njësi, me sip. 45 m2 në Selitë, Tiranë, në pronësi të subjektit.**
- ✓ **Subjekti ka paraqitur dokumentacion në lidhje me burimin financiar të përdorur për blerjen e njësisë, ndër të tjera edhe për aktivitetin e babait të bashkëshortes, z. B.H, që i përket periudhës 1993 - 1997.**
- ✓ **Ka dhënë sqarime në lidhje me vlerën e deklaruar prej 2.233.000 lekë, të paguar nga ana e tij për këtë pasuri, shtetasve R.A dhe H.Q, pasi diferenca e çmimit, sipas kontratës, nuk i është likuiduar vëllait S.J, në marrëveshje ndërmjet tyre. Gjithashtu, shpenzimet për punimet e papërfunduara kanë si burim kredinë në Tirana Bank.**

4. Njësi me sip. 174 m2, regjistruar në datë 21.09.2007, numër pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, në shumën 12.750.000 lekë. Vlera reale e likuiduar nga ana ime është në shumën 8.500.000 lekë. Për pjesën takuese kundrejt vëllait tim S.J, nuk kam detyrim financiar, për faktin se, njësia është marrë në karabina. Burimi, kursime nga të ardhurat familjare ndër vite, nga paga ime dhe e bashkëshortes, përfshirë nga të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit dhe vëllezërve. Likuidimi total i kësaj njësie referuar vlerës totale të blerjes ka përfunduar në vitin 2020. Vlera 12.750.000 lekë. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 17.08.2007, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 174 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në emër të R.A, H.Q dhe S.J. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, me palë shitëse R.A, H.Q dhe S.J dhe blerës Rebani Jaupi, për pasurinë njësi, me nr. ***, me sip. 174 m2, e ndodhur në Selitë, Tiranë, në vlerën 12.750.000 lekë, vlerë e paguar jashtë zyrës noteriale.

➤ Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 21.09.2007, për pasurinë njësi, me nr. ***, me sip. 174 m², e ndodhur në Selitë, Tiranë, në emër të Rebani Jaupi.

✚ **ASHK, Drejtoria Vendore, Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. *** prot, datë 23.06.2023, konfirmon të regjistruar në emër të Rebani Jaupi, pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit njësi, me sip. 174 m², e ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në datë 25.09.2007. Pasuria ka shënimet si vijon: datë 22.11.2011, "Në favor të Emporiki Bank, për shumën 70.000 euro", datë 30.10.2012 "Në favor të Emporiki Bank, për shumën 490.000 euro", datë 18.07.2013 "Në favor të Credit Agricole Shqipëri, për shumën 490.000 euro" dhe në datë 26.01.2015 "Hipotekohet në favor të Credit Agricole Shqipëri, për shumën 150.000 euro". Bashkëlidhur praktika.

- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se njësia me sipërfaqe 174 m², përfiturar përmes kontratës së shitblerjes, datë 13.09.2007 është në pallatin e ndërtuar nga firma "****" shpk, me investim të tre ortakëve bashkëinvestitore, R.A, H.Q dhe S.J. Vlera e likuiduar nga ana e tij për këtë pasuri është në shumën 8.500.000 lekë, paguar ortakëve të vëllait, H.Q dhe R.A, në vitin 2007, nga vlera e përcaktuar në kontratë prej 12.750.000 lekë, pra ka paguar 2/3 e kësaj vlere. Për pjesën takuese të vëllait të tij S.J, në këtë pasuri, nuk është kryer pagesë nga subjekti, pasi kjo pasuri ishte pjesërisht e përfunduar, në pjesën e brendshme të saj, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me të. Subjekti deklaroi gjithashtu se, për të vërtetuar këtë fakt, në vitin 2007 ka marrë edhe një kredi bankare tek Tirana Bank, në vlerën rreth 20.000 euro, për rikonstruksionin e dyqaneve të blera në vitin 2007. Subjekti deklaroi se nuk ka pretendime apo detyrime me vëllain e tij për këtë pasuri, pasi ai ka shlyer detyrimin kundrejt dy ortakëve të tjerë. Si burim për blerjen e kësaj prone, kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare ndër vite, si dhe dhurimi i bërë nga mamaja e bashkëshortes, në vitin 2007, në vlerën 50.000 USD, me burim nga aktiviteti privat i vjehrrit B.H, nga shoqëria "****", deri në vitin 2002, për të cilat mund të disponojë pjesërisht dokumentacion justifikues përkatës. Në lidhje me faktin që ka deklaruar se likuidimi total i kësaj njësie, ka përfunduar në vitin 2020, sqaron se ky deklaram i përket njësisë me sip. 100 m², blerë nga vëllezërit e tij në vitin 2012, por gabimisht është shprehur edhe në këtë pasuri.

Përsa i përket faktit që kjo pasuri është vendosur kolateral në favor të Emporiki Bank dhe Credit Agricole, në atë periudhë, sqaron se nuk është kredimarrës, por vetëm hipotekues. Në kontratën e hipotekës të vitit 2012, konstatohet fakti se subjekti dhe bashkëshortja janë hipotekues. Kredimarrës është shoqëria "****" shpk, ku nipi i subjektit, shtetasi E.J, ishte ortak në këtë shoqëri. Vlera e kredisë prej 490.000 euro është marrë në formën e kontratës së kredisë bankare, e cila garantohet me këtë kontratë. Subjekti sqaron se nuk ka marrë fonde, por thjesht ka vendosur pronën hipotekë për kredinë e marrë nga shoqëria "****" shpk dhe për të ndihmuar nipin e tij. Në kontratën e hipotekës së vitit 2015, sqaron se subjekti dhe bashkëshortja janë hipotekues dhe kredimarrës është nipi i subjektit, E.J. Kjo kredi është ristrukturim i kredisë prej 490.000 euro të marrë nga shoqëria "****" shpk. Pasi shtetasi E.J është larguar si ortak nga Shoqëria "****" shpk, pjesën e kredisë në vlerën 150.000 euro, e ka kaluar si kredi personale, duke mbajtur hipotekues pasurinë e subjektit. Shuma e kredisë prej 150.000 euro është trajtuar si kredi individuale për E.J nga banka. Subjekti sqaron se, gjithashtu, edhe kredia në vlerën 70.000 euro në vitin 2011, është pjesë përbërëse e këtyre kredive bankare për nipin e tij dhe se

subjekti Rebani Jaupi, nuk ka marrë apo përfitur asnjëherë fonde apo kredi nga vlerat e cituara në kartelën e pasurisë, por thjesht ka vendosur pronën e tij si garanci hipotekore për kreditë e marra nga shoqëria “***” shpk, për nipin e tij E.J. Kjo është bërë nga ana e tij, për të ndihmuar nipin e tij, pasi është djali i vëllait S.J, me të cilin ka raporte shumë të afërta, si dhe janë bashkëpronarë në pasuri të përbashkëta.

Me inventarin e datës 06.11.2023, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 04.11.2023, me palë deklaruese R.A, H.Q dhe S.J, të cilët deklarojnë se kanë qënë bashkëinvestitorë në objektin godinë banimi dhe shërbimi në Selitë, Tiranë, e cila ishte ndërtuar rreth viteve 2003 - 2007, nga shoqëria “****” shpk, në pronësi të deklaruesve. Ky objekt u regjistrua, pasi ishin paguar të gjitha detyrimet tatimore sa i takonte investitorëve dhe kompanisë së ndërtimit, sipas çmimeve reference të përcaktuara nga ZRPP. Referuar sa më sipër palët deklarojnë se në vijim është kryer kontrata e shitjes kundrejt shtetasit Rebani Jaupi, për pasurinë si vijon: Pasuria me nr. ***, me sip. 174 m2, i është shitur shtetasit Rebani Jaupi, sipas kontratës nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.09.2007, në vlerën totale 12.750.000 lekë. Palët deklarojnë se kjo pronë, në momentin e shitjes nga pala e deklaruesve si investitorë, ka qënë pjesërisht e përfunduar në pjesën e brendshme të saj. Deklaruesit, H.Q dhe R.A, deklarojnë se kanë marrë nga Rebani Jaupi në vitin 2007, vlerën prej 8.500.000 lekë, për pjesën e tyre takuese, nga vlera totale e kontratës së shitjes së kësaj pasurie.
Shtetasi S.J deklaron se, për pjesën e tij takuese prej 1/3 në këtë pasuri, nuk ka kërkuar pagesë nga subjekti, pasi kjo pasuri ishte pjesërisht e përfunduar, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me vëllain e tij. Deklaron se nuk ka pretendime apo detyrime me vëllain e tij Rebani Jaupi për këtë pasuri, pasi ai ka shlyer detyrimin kundrejt dy ortakëve të tjerë.
- Ekstrakt historik i shoqërisë “****” shpk, me Nipt ***, themeluar në vitin 1999, me objekt "Projektim i strukturave të zakonshme prej murature tulle, betoni, ndërtime civile, industriale etj", me ortak dhe administrator shetasin R.A. Kjo shoqëri rezulton e regjistruar me vendim të Gjykatës së Tiranës në vitin 1999, me përfaqësues ligjor dhe ortak shtetasin R.A.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 02.11.2023, me palë deklaruese A.H, e cila deklaron se në vitin 2007, i ka dhënë vajzës Elvira Hoxha, shumën 50.000 USD, si dhuratë nga kursimet familjare të përfutuara nga aktiviteti ekonomik-tragtar i kompanisë “****”, që i përkiste bashkëshortit të saj shtetasit B.H, gjatë viteve 1992 - 2002. Kjo për arsye se vajza është pjesë me një të tretën, sipas deklaratës së trashëgimisë së babait të saj z. B.H, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2002.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1993, firmosur nga pronari B.H, ku rezulton fitimi neto në vlerën 114.970 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1994, firmosur nga pronari B.H, ku rezulton fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 222.428 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 137.129 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1995, firmosur nga pronari B.H, ku rezulton fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 427.940 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 561.560 lekë.

- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1996, firmosur nga pronari B.H, ku rezulton fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 267.869 lekë dhe nga aktiviteti ndërtues 713.598 lekë.
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, për vitin 1997, firmosur nga pronari B.H, ku rezulton fitimi neto nga aktiviteti tregtar, në vlerën 733.548 leke.
- Kontratë shitblerje datë 05.11.1993, me shitës shoqëria “****”, me pronar B.H dhe blerës A.T, për traktor tip Biellorus, në vlerën 1.750.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 07.06.1993, me palë shitëse shoqëria “****”, me pronar B.H dhe blerës Sh.B, për traktor tip Biellorus, në vlerën 500.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 17.03.1993, me palë shitëse shoqëria “****”, me pronar B.H dhe blerës A.K, për traktor tip Biellorus, në vlerën 820.000 lekë.
- Kontratë hipoteke nr. *** rep. nr. *** kol, datë 28.10.2011, me palë Banka Emporiki Shqipëri sha, dhe palë hipotekuese Rebani dhe Elvira Jaupi, për kredi në vlerën 70.000 euro, që banka i ka dhënë shoqërisë “****” shpk, në shumën 70.000 euro, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep. nr. *** kol, datë 26.10.2011. Objekti i kësaj kontrate është vënia e hipotekës në favor të bankës, e pasurisë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, me sip. 174 m2, në pronësi të Rebani Jaupi. Bashkëlidhur kontrata e kredisë bankare nr. *** rep. nr. *** kol, datë 26.10.2011.
- Kontratë hipoteke nr. *** rep. nr. *** kol, datë 11.10.2012, me palë Banka Emporiki Shqipëri sha, shoqëria “****” shpk, përfaqësuar nga E.J dhe A.S, si dhe Rebani dhe Elvira Jaupi hipotekuesit, për kredinë në vlerën 490.000 euro, që banka i ka dhënë kredimarrësit, shoqërisë “****” shpk, sipas kontratave të datës 11.10.2012, në vlerën 50.000 euro dhe 440.000 euro. Objekti i kësaj kontrate është vënie e hipotekës në favor të bankës, për pasurinë e Rebani Jaupi me nr. ***, me sip. 174 m2, si dhe dy pasuri në emër të shoqërisë “****” shpk. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë hipoteke nr. *** rep. nr. *** kol, datë 13.01.2015, me palë Banka Credit Agricole Shqipëri sha, dhe palë hipotekues Rebani, Elvira, S.J dhe P.Jaupi, për kredinë në vlerën 150.000 euro, që banka i ka dhënë kredimarrësit E.J, sipas kontratës së huasë së datës 13.01.2015, e cila garantohet me këtë kontratë. Objekti i kësaj kontrate është vënie e hipotekës në favor të bankës, për pasurinë e Rebani Jaupi, me nr. ***, me sip. 174 m2 dhe S.J me nr. ***, për kredinë e sipërcituar. Bashkëlidhur praktika.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Njësia me sip. 174 m2, me adresë në Selitë, Tiranë, është blerë me kontratën e vitit 2007, me çmim 12.750.000 lekë, nga bashkëinvestitorët R.A, H.Q dhe S.J. Sipas sqarimeve të subjektit për këtë njësi, shuma e paguar nga ana e tij është 8.500.000 lekë, në vitin 2007, ortakëve të vëllait të tij, R.A dhe H.Q. Për pjesën takuese të S.J, në këtë pasuri nuk është kryer pagesë, pasi ishte pjesërisht e përfunduar, si dhe për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta me vëllain e tij.

Në vitin 2007, subjekti ka marrë kredi në shumën 20.000 Euro në Tirana Bank, përdorur për përfundimin e punimeve të kësaj njësie, si dhe për njësinë tjetër në Selitë (trajtuar tek kredia bankare e deklaruar më poshtë).

- ✓ **ASHK konfirmon pasurinë, njësi me sip. 174 m2 në Selitë, Tiranë, në pronësi të subjektit.**
 - ✓ **Subjekti ka paraqitur dokumentacion në lidhje me burimin financiar të përdorur për blerjen e njësisë, ndër të tjera edhe për aktivitetin e babait të bashkëshortes, z. B.H, që i përket periudhës 1993 - 1997.**
 - ✓ **Ka dhënë sqarime në lidhje me vlerën e deklaruar, prej 8.500.000 lekë, të pagua nga ana e tij për këtë pasuri, shtetasve R.A dhe H.O, pasi diferenca e çmimit, sipas kontratës, nuk i është likuiduar vëllait S.J, në marrëveshje ndërmjet tyre. Gjithashtu, shpenzimet për punimet e papërfunduara kanë si burim kredinë në Tirana Bank.**
5. **Njësi me sip. 100 m2**, regjistruar në datë 29.02.2012, me numër pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë, blerë në vitin 2012, me adresë rruga “****”, Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.02.2012, në shumën 10.000.000 lekë. Vlera reale e likuiduar nga ana ime është në shumën 5.000.000 lekë. Për pjesën takuese kundrejt vëllait tim S.J nuk kam detyrim financiar, për faktin se njësia është marrë në karabina. Burimi, kursime nga të ardhurat familjare ndër vite, nga paga ime dhe e bashkëshortes, përfshirë nga të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit dhe vëllezërve. Likuidimi total i kësaj njësie referuar vlerës totale të blerjes ka përfunduar në vitin 2020. Vlera 10.000.000 lekë. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 07.02.2012, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 100 m2, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në emër të S.J dhe Sh.J. Bashkëlidhur praktika.
 - Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.02.2012, me palë shitese S.J dhe Sh.J dhe blerës Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 100 m2, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vlerën 10.000.000 lekë, vlerë e cila është shlyer totalisht para lidhjes së kontratës.
- 🇫🇰 **ASHK, Drejtoria Vendore, Tiranë, Jug**, me shkresën nr. *** prot, datë 26.06.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***. Bashkëlidhur kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep. nr. *** kol, datë 23.02.2012, me palë shitese S.J dhe Sh.J dhe blerës Rebani Jaupi, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, me sip. 100 m2, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vlerën 10.000.000 lekë, vlerë e cila është shlyer totalisht para lidhjes së kontratës. Bashkëlidhur gjithashtu edhe praktika për këtë pasuri.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka dhënë shpjegime me shkrim, në lidhje me njësinë me sip. 100 m2, blerë në vitin 2012, me adresë në rrugën “****” Tiranë, në vlerën e përcaktuar në kontratë prej 10.000.000 lekë, ku sqaron se vëllezërit e tij S.J dhe Sh.J, në cilësinë e investitorit, kanë ndërtuar një objekt "Godinë Banimi dhe Shërbimi", ndërtuar nga firma “****” shpk, me administrator dhe ortak vëllain e tij Sh.J. Vlera e likuiduar nga ana e tij kundrejt vëllezërve për këtë pasuri është 5.000.000 lekë. Kjo vlerë i referohet vlerës së objektit në gjendjen që ishte, pra e papërfunduar plotësisht, për të cilën ishte rënë dakort me vëllezërit e tij S.J dhe Sh.J, pavarësisht çmimit të përcaktuar në kontratë. Punimet e brendshme të kësaj njësie, si dhe përshtatja e tij në ambjent për qiramarrësin, ka kushtuar rreth 800.000 lekë, me burim të ardhurat familjare, si dhe parapagim nga qiratë e para

të marra nga qiramarrësi në vitin 2012. Nuk disponon dokumentacion në lidhje me këto shpenzime, pasi ka kaluar kohë e gjatë.

Vlera prej 8.500.000 lekë është shlyer kundrejt vëllezërve për periudhën deri në vitin 2020, me këste vjetore në cash, sipas mundësive vit pas viti. Subjekti sqaroi se kjo mënyrë likuidimi është bërë e tillë, duke qënë një marrëdhënie e afërt midis vëllezërve. Si burim për blerjen e kësaj prone kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare ndër vite, të subjektit dhe bashkëshortes, përfshirë të ardhurat nga qiratë.

Me inventarin e datës 06.11.2023, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol, datë 04.11.2023, me palë deklaruese S.J dhe Sh.J, të cilët deklarojnë se janë vëllezër dhe kanë qënë bashkëinvestitore, në objektin e ndërtuar, godinë banimi dhe shërbimi, me adresë në rrugën “****” Tiranë, rreth viteve 2005 - 2009, ndërtuar nga shoqëria “****” shpk, me administrator dhe ortak Sh.J. Objekti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit të datës 04.02.2005, nga KRRT Bashkia Tiranë. Palët deklarojnë se i kanë shitur vëllait të tyre Rebani Jaupi, në vitin 2012, pasurinë me nr. ***, me sip. 100 m2, në vlerën e përcaktuar në kontratë prej 10.000.000 lekë, vlerë e cila është deklaruar në zyrën e tatim taksave dhe në kontratën e shitblerjes. Njësia në fjalë, në momentin e shitjes ishte në karabina (e papërfunduar plotësisht), dhe për këtë arsye kishte një vlerë rreth 5.000.000 lekë, pavarësisht vlerës së përcaktuar në kontratë. Palët deklarojnë se pikërisht kjo ka qënë vlera reale e shitjes së kësaj pasurie dhe që vëllai i tyre Rebani Jaupi ka paguar për këtë pasuri, pavarësisht vlerës së vendosur në kontratë. Kjo vlerë është shlyer nga Rebani Jaupi, për periudhën deri në vitin 2020, me këste vjetore në cash, sipas mundësive të tij. Vlera është shlyer totalisht dhe nuk ka detyrime financiare apo pretendime për këtë pasuri. Palët deklarojnë se përsa i përket shlyerjes, duke qënë vëllezër e kanë trajtuar ndryshe nga një blerës i zakonshëm.
- Leje ndërtimi nr. *** prot, datë 04.02.2005, subjektit ndërtues “****” me investitor S.J dhe Sh.J, për godinë banimi dhe shërbimi 7 dhe 8 kat, dhe 2 kat nëntokë, e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, datë 04.11.2004, për regjistrimin e personit juridik “****” shpk, me ortak dhe administrator shtetasin Sh.J

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Njësia me sip. 100 m2, me adresë në rrugën “****” Tiranë, me vlerë 10.000.000 lekë, sipas kontratës së vitit 2012, sipas sqarimeve, është blerë nga subjekti duke i paguar vëllezërve S.J dhe Sh.J, shumën 5.000.000 lekë, për arsye se ka qënë pronë e tyre dhe në gjendje të papërfunduar. Sipas sqarimeve, kjo shumë është shlyer gjatë periudhës 2012 - 2020, duke mos pasur më detyrime financiare ndaj vëllezërve, formalizuar me deklaratë noteriale. Subjekti ka deklaruar shpenzime për përfundim të punimeve dhe përshtatje ambjenti për qiramarrësin, në vlerën totale rreth 800.000 lekë.

- ✓ **ASHK konfirmon pasurinë njësi me sip. 100 m2, në Rr. “****” Tiranë në pronësi të subjektit.**
 - ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me vlerën e deklaruar, prej 5.000.000 lekë, të paguar nga ana e tij gjatë periudhës 2012 - 2020, pavarësisht vlerës në kontratë prej 10.000.000 lekë, e bazuar në çmimin referencë.**
 - ✓ **Ka dhënë sqarime në lidhje me vlerën e deklaruar, prej 5.000.000 lekë, të paguar nga ana e tij për këtë pasuri, vëllezërve S.J dhe Sh.J, pasi diferenca e çmimit, sipas kontratës, nuk është likuiduar në marrëveshje ndërmjet tyre. Shpenzimet për punimet e papërfunduara janë deklaruar rreth 800.000 lekë.**
6. **Gjendje në llogarinë bankare Credins Bank, në datën 10.03.2023, me burim nga qiraja e ambjenteve me Credins Bank, shuma 47.297 euro. Zotëron 100 %.**
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. **** prot, datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari rrjedhëse në euro, me gjendje në datën 10.03.2023, në vlerën 48.647 euro. Konfirmohet se për periudhën 31.05.2016 deri më 10.03.2023, kreditohet nga “****” qiraja e magazinës-arkivë, si dhe “****” shpk.
- ✓ **Credins Bank konfirmon gjendjen e llogarisë në datën 10.03.2023, në vlerën 48.647 euro, me burim nga qiratë.**
7. **Gjendje e llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank, datë 10.03.2023, shuma 970.333 lekë. Zotëron 100 %.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 28.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.2020 deri më datë 29.02.2023.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari page në lekë, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 1.020.333 lekë. Konfirmohen kreditimet nga paga.
- ✓ **Raiffeisen Bank konfirmon gjendjen e llogarisë së pagës në datën 10.03.2023, në vlerën 1.055.186 lekë.**
8. **Gjendje cash jashtë sistemit bankar, me burim të ardhurat nga kursimet familjare, vlera 600.000 lekë. Zotëron 50 %.**
- ✓ **Të ardhurat familjare mundësojnë gjendje cash të deklaruar.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

9. Të ardhura nga paga pranë Repartit NSH-Tiranë, në pozicionin "Komandant Grupi", periudha 16 janar 1991 deri më 15 tetor 1993, shuma 92.568 lekë.
10. Të ardhura nga paga, shpërblimet dhe orë suplementare përkatësisht: Specialist i Policisë Kriminale në komisariatit nr. 2 Tiranë, Specialist i Policisë Kriminale në komisariatit nr. 3 Tiranë, Shef i Policisë Kriminale në Komisariatit e Policisë nr. 3, Tiranë. Periudha 01.01.1994 - 23.07.2000. Të ardhura nga taksa e solidaritetit, periudha 1997 - 2000, me përafërsi 834.511 lekë. Të ardhura nga orë suplementare, periudha 01.01.1994 - 23.07.2000, përafërsisht 430.170 lekë. Të ardhura nga shpërblimet, periudha 01.01.1994 - 23.07.2000, përafërsisht 168.826 lekë. Shuma 2.146.535 lekë.
11. Të ardhura nga paga, shpërblimet, taksa e solidaritetit, për periudhën 24 korrik 2000 deri në 31 maj 2001, në DVP Elbasan, në pozicionin Shef Komisariati i Policisë Peqin, shuma 314.375 lekë.
12. Të ardhura nga paga në periudhën 01.07.2001 - 20.10.2005, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas vërtetimit nr. 1385, datë 12.04.2018, shuma 2.358.924 lekë.
13. Të ardhura nga paga dhe shpërblime për periudhën 25.03.2004 deri në 08.10.2004, pranë DVP Tiranë, në pozicionin Zv/Drejtor i Policisë, shuma 353.754 lekë.
14. Të ardhura nga paga dhe shpërblime për periudhën tetor 2005 - qershor 2006, pranë DVP Berat, në pozicionin Drejtor i policisë. Qershor 2006 deri në tetor 2006, Asistent i Zv Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, shuma 1.462.638 lekë.
15. Të ardhura nga pagesat e reformës së Policisë për periudhën tetor 2006 dhe qershor 2009, shuma 1.354.820 lekë.
16. Të ardhura nga paga në sektorin privat pranë shoqërisë Edmeli shpk, periudha maj 2010 - dhjetor 2010, qershor 2011 - janar 2014, shuma 844.979 lekë.
17. Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, periudha 20.01.2014 - 12.05.2014, në pozicionin Shef i Sektorit të Hetimit në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, shuma 306.447 lekë.
18. Të ardhura nga paga në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, në pozicionin Zv/Drejtor i Policisë Tiranë, për periudhën 12.05.2014 - 31.12.2014, shuma 625.057 lekë.
19. Të ardhura nga paga, shpërblime, uniforma, në DPP, periudha 01.01.2015 - 29.05.2019, shuma 5.101.088 lekë.
20. Të ardhura nga paga, shpërblime, orë suplementare, uniforma, leje në pozicionin Drejtor i DVP Tiranë, për periudhën 30.05.2019 deri në 21.10.2021, shuma 3.513.253 lekë.
21. Të ardhura nga paga, shpërblime, orë suplementare, uniforma, leje në pozicionin Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike, në DPPSH për periudhën 22.10.2021 deri në 31.12.2021, shuma 441.240 lekë.
22. Të ardhura nga paga, shpërblime, orë suplementare, uniforma, leje në pozicionin Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike, në DPPSH, për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, shuma 1.649.626 lekë.
23. Të ardhura nga paga, paketë ndihmë në pozicionin e Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike, në DPPSH, për periudhën 01.01.2023 deri në 07.03.2023, shuma 268.810 lekë.
24. Shitje automjeti Mercedes Benz viti 1999, kontratë shitje datë 20.12.2014, nr. ***, automjet i blerë në vitin 2006. Shuma 200.000 lekë.
25. Të ardhura nga dhënia me qira e truallit me sip. 3.000 m2, subjektit "****", periudha e kontratës 3 vjeçare, duke filluar nga viti 2015, 2016 dhe 2017. Vlera e kontratës 20.000 euro. Është

paguar tatimi në burim 2.609 euro. Të ardhurat neto të kontratës janë 17.391 euro, shumë e cila është në bashkëpronësi me vëllezërit S.J dhe Sh.J. Nga kjo shumë unë kam përfituar 33 % të vlerës totale. Shuma 5.797 euro.

26. Të ardhura nga dhënia me qira “****” të dyqanit me sip. 174 m2 dhe 45 m2 me adresë “****”, Tiranë, për periudhën maj 2016 deri në 08.03.2023, me kontratë qiraje nr. *** rep. nr. *** kol, datë 08.02.2016. Kjo kontratë ishte lidhur me vlerë 750 euro. Është paguar tatimi në burim dhe të ardhurat neto janë 637 euro. Shuma 52.000 euro.
27. Të ardhura neto në vlerën 6 5.000 lekë në muaj, sipas kontratës me kompaninë “****”, nga qiraja e dyqanit me sip. 100 m2, me adresë rruga “****” Tiranë. Periudha janar 2012 - 2013, sipas kontratës datë 01.02.2012. Shuma 1.560.000 lekë.
28. Të ardhura neto sipas kontratave në shumën nga 46.750 deri në 52.250 lekë, nga qiraja e dyqanit me sip. 100 m2, me adresë rruga “****”, periudha janar 2014 - vazhdim. Shuma 6.644.988 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim për bazën e vlerësuar nga DVP Tiranë, datë 05.10.2020, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.08.1990 - 15.11.1990 dhe 16.10.1993 - 31.12.1993, ka përfituar pagë neto në vlerën totale 16.610 lekë.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme nga Reparti NSH Tiranë, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 16.01.1991 - 15.10.1993, ka përfituar të ardhura neto nga paga në vlerën totale 92.568 lekë.
- Vërtetim nga DVP Tiranë, datë 12.04.2018, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.1994 - 23.07.2000 dhe 25.03.2004 - 08.10.2004, ka përfituar të ardhura në vlerën totale neto 1.066.782 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DVP Tiranë, datë 19.07.2019, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.1994 - 23.07.2000 dhe 25.03.2004 - 08.10.2004, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në vlerën totale 1.823.862 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DVP Tiranë, datë 19.07.2019, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.1999 - 23.07.2000, ka realizuar të ardhura nga taksa e solidaritetit në vlerën totale neto 161.336 lekë.
- Flet-anketa personale e kuadrit, për shtetasin Rebani Jaupi, për studimin dhe punësimin.
- Kërkim të dhënash nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, datë 08.07.2019, drejtuar DVP Tiranë, për të ardhurat e Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.1994 - 23.07.2000 dhe 25.03.2004 - 8.10.2004.
- Listë pagesat e punonjësve të Komisarariatit nr. 2/1 Tiranë, në formë tabelash, ku ndër të tjera figuron edhe emri i Rebani Jaupi, për periudhën 1 janar deri në 03.07.1994, dhe pjesërisht për vitin 1996.
- Borderotë e pagave, në formë tabelash, ku ndër të tjera figuron edhe emri i Rebani Jaupi, për periudhën 18.02.1998 deri në 18.04.1999.
- Borderotë e pagave, në formë tabelash, ku ndër të tjera figuron edhe emri i Rebani Jaupi, për periudhën 18.04.2004 - 18.10.2004.
- Listë pagesat e punonjësve, në formë tabelash, ku ndër të tjera figuron edhe emri i Rebani Jaupi, për periudhën prill 1998 - 03.08.2000.

- Kthim përgjigje nga DPV Elbasan, datë 10.07.2019, drejtuar Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e cila bën me dije se Rebani Jaupi, për periudhën 24.07.2000 - 31.05.2001, ka përfituar të ardhura neto nga paga në vlerën totale 237.886 lekë dhe taksa e solidaritetit në vlerën 67.489 lekë, nga shpërblimet 89.054 lekë dhe orët suplementare 19.675 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DPPP, datë 23.07.2019, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.07.2001 - 24.03.2004 dhe 09.10.2004 - nëntor 2005, ka përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën totale 2.358.864 lekë dhe 16.06.2006 - 30.06.2009, në vlerën totale 1.691.963 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DVP Berat, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 21.10.2005 - 15.06.2006, ka përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën totale 562.332 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Arkivit të Rajonit Tiranë, datë 10.07.2019, që vërteton pagat bruto të Rebani Jaupi, për periudhën maj 2010 - dhjetor 2012, nga subjekti "Edmeli".
- Vërtetim nga DRSSH Tiranë, datë 11.07.2019, për kontributet e Rebani Jaupi, për vitin 2013, nga subjekti "Edmeli".
- Vërtetim nga shoqëria Edmeli shpk, datë 22.07.2019, që vërteton se Rebani Jaupi, ka qënë i punësuar si përgjegjës sektori pranë kësaj shoqërie, për periudhën maj 2010 - janar 2014 dhe ka përfituar të ardhura nga paga në vlerën totale neto prej 844.979 lekë.
- Vërtetim page nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, datë 25.03.2015, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 12.05.2014 - 31.12.2014, ka përfituar të ardhura neto nga paga në vlerën totale prej 625.057 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DVP Tiranë, datë 05.10.2020, që konfirmon paga dhe shpërblime neto të Rebani Jaupi, për periudhën maj 2014 - prill 2015, në vlerën totale 1.347.155 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga DPPP Tiranë, datë 23.07.2019, që konfirmon paga dhe shpërblime neto të Rebani Jaupi, për periudhën 18.11.2015 - 01.06.2019, në vlerën totale 5.101.088 lekë.
- Vërtetim nga DVP Tiranë, datë 12.03.2020, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën qershor - dhjetor 2019, ka përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën 650.480 lekë.
- Vërtetim nga DVP Tiranë, datë 21.02.2023, në formë tabele, që konfirmon pagat neto të Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, në vlerën totale 1.616.902 lekë.
- Vërtetim nga DVP Tiranë, datë 28.02.2022, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën janar - tetor 2021, ka përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën 1.242.732 lekë.
- Vërtetim nga financa e DPPSH, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 22.10.2021 - 31.12.2021, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime neto, në vlerën totale 441.240 lekë.
- Vërtetim nga financa e DPPSH, që vërteton se Rebani Jaupi, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime neto, në vlerën totale 1.649.626 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 06.04.2018, për llogari në lekë, në emër të Rebani Jaupi, për periudhën 04.05.2005 deri më datë 15.09.2010.
- Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 11.03.2020, për llogari në lekë, në emër të Rebani Jaupi, për periudhën 03.01.2019 deri më datë 31.12.2019.
- Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 28.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Rebani Jaupi, për periudhën 27.10.2020 deri më datë 31.01.2023.

- Kontratë qiraje, nr. *** rep. nr. *** kol, datë 08.02.2016, me palë qiradhënëse Rebani Jaupi dhe qiramarrës “***”, për dhënien me qira të njësisë me sip. 45 m2, me nr. ***, dhe njësisë me sip. 174 m2, me nr. ***, në vlerën 750 euro në muaj bruto, pagesë e cila do të kryhet në llogarinë e Credins Bank. Kontrata e qirasë është për një periudhë 10 vjeçare. Detyrimet lidhur me pasurinë e paluajtshme i takojnë qiradhënësit.
 - Kontratë qiraje, nr. *** rep. nr. *** kol, datë 21.09.2016, me palë qiradhënëse Sh.J, S.J dhe Rebani Jaupi dhe qiramarrës shoqëria “***” shpk, për dhënien me qira të një pasurie të llojit ullishte me sip. 3.000 m2, me nr. ***, e ndodhur në rrugën “***” Tiranë, në vlerën 555.5 euro në muaj. Kjo pasuri i është dorëzuar qiramarrësit 2 vite përpara nënshkrimit të kontratës. Kjo shumë, minus tatimin në burim prej 15 %, do të paguhet nga qiramarrësi në 3 këste. Palët deklarojnë se për të gjithë kohëzgjatjen e marrëdhënies së tyre, nga data 01.11.2014 deri 01.11.2017, qiramarrësi i detyrohet qiradhënësve në vlerën totale bruto prej 20.000 euro. Pagesa do të bëhet me 3 këste si vijon: Kësti i parë prej 6.667 euro do të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, kësti i dytë prej 6.667 euro do të bëhet brenda datës 30.11.2016 dhe kësti i tretë prej 6.666 euro do të bëhet brenda datës 31.11.2017.
 - Kontratë qiraje datë 01.02.2012, me palë qiradhënëse Rebani Jaupi dhe qiramarrës shoqëria “***” me objekt dhënien me qira të një njësie me sip. 100 m2, me nr. ***, e ndodhur në Tiranë, në vlerën 65.000 lekë në muaj neto. Taksat që lindin nga ushtrimi i aktivitetit do të paguhet nga qiramarrësi. Kohëzgjatja e kontratës është nga data 05.01.2012 deri më 04.01.2013, me të drejtë rinovimi në mënyrë automatike.
 - Kontratë qiraje datë 01.05.2014, me palë qiradhënëse Rebani Jaupi dhe qiramarrës A.C, Person Fizik, me objekt dhënien me qira të një njësie me sip. 100 m2, me nr. ***, e ndodhur në Tiranë, në vlerën 63.000 lekë në muaj, neto. Taksat që lindin si rezultat i dhënies me qira do të paguhet nga qiradhënësi, sikundër edhe tatimi në burim. Kohëzgjatja e kontratës është nga data 01.05.2014 deri në 30.04.2015. Palët bien dakort të rinovojnë kontratën në rast se do të kërkohet nga qiramarrësi.
 - Kontratë qiraje datë 01.02.2018, me qiradhënëse Rebani Jaupi dhe qiramarrës kompania “***” përfaqësuar nga administratori A.C, palë qiramarrëse, me objekt dhënien me qira të një njësie me sip. 100 m2, me nr. ***, e ndodhur në Tiranë, në vlerën 63.000 lekë në muaj, neto. Taksat që lindin si rezultat i dhënies me qira do të paguhet nga qiradhënësi, sikundër edhe tatimi në burim. Kohëzgjatja e kontratës është nga data 01.02.2018 deri në 31.01.2019.
 - Kontratë shitje automjeti, nr. *** rep. nr. *** kol, datë 20.12.2014, me palë shitëse Rebani Jaupi dhe blerës shoqëria “***” sha, për automjet tip Mercedes Benz, tip ***, viti 1999, në vlerën 200.000 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, ku konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari page në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe shpërblime për periudhën 04.05.2005 - 01.07.2009, në vlerën totale 3.251.712 lekë, si dhe për periudhën 03.02.2014 - 02.03.2023, nga paga, shpërblime, veshje, ndihmë, telefoni, në vlerën totale 13.592.443 lekë.
- ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi llogari në lekë, ku konfirmon kreditime page nga Edmeli shpk, konkretisht; në datën

24.12.2010, vlera 137.141 lekë, në datën 09.05.2012, vlera 272.910 lekë, dhe në datën 26.12.2013, vlera 243.308 lekë.

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari rrjedhëse në euro, ku konfirmohet se për periudhën 31.05.2016 deri më 10.03.2023, kreditohet nga “****” qiraja e magazinë-arkivë, në vlerën mujore neto prej 637 Euro, në total në shumën 52.911 euro, si dhe “****” shpk, në vlerën totale 14.960 euro.
Konfirmon në emër të Rebani, Sami dhe Shkëlqim Jaupi, llogari në euro, ku konstatohet se për periudhën 23.09.2016 deri më 11.05.2018, transferohet nga “****”, me përshkrimin "Parking rent", në vlerën totale 19.760 euro.
Konfirmon në emër të Kleard Jaupi, llogari në lekë, ku ka përfituar për periudhën 2014, dhënie stimuli, në vlerën totale 27.000 lekë.
- ✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, automjetin me targë ***, tip Mercedes, tip ***, viti 1999, blerë sipas kontratës nr. *** rep. nr. *** kol, datë 22.08.2006, me palë shitës Xh.S dhe blerës Rebani Jaupi, në vlerën 500.000 leke, vlerë e cila është likuiduar.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon pagat bruto/neto të Rebani Jaupi, për periudhën maj 2012 - mars 2023, në subjektet (Edmeli, Apar. Qendr. I Dep. Për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Policisë, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria Për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, Drejtoria e përgjithshme e Policisë).
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Rebani Jaupi rezulton i regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA, për periudhën 2019 - 2022. Lidhur me kontratën e qirasë datë 01.02.2012, me qiramarrës subjektin “****”, nuk u gjend ndonjë transaksion për tatimin mbi qiranë. Lidhur me kontratën e qirasë datë 01.05.2014, me qiramarrës subjektin A.Ç, rezultojnë pagesa për periudhën qershor 2015 - maj 2017, në shumën totale 153.045 lekë. Lidhur me kontratën e qirasë datë 01.05.2014, me qiramarrës subjektin “****”, rezultojnë pagesa për periudhën janar 2020 - maj 2023, në vlerën totale 561.750 lekë. Bashkëlidhur praktika.
- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot, datë 26.7.2023, konfirmon në lidhje me kontratën e qirasë së datës 21.09.2016, me palë qiramarrëse “****”, ku sqaron se është deklaruar në sistem, po ashtu edhe kontrata e datës 08.02.2016 me qiramarrës “****”. Bashkëlidhur praktika.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti në lidhje me kontratat e qirasë për njësinë me sip. 100 m², ka sqaruar se pavarësisht afateve të vendosura në kontratat përkatëse ato kanë vazhduar dhe janë rinovuar automatikisht, nga viti 2012 dhe në vazhdim pa ndërprerje, si nga “****” për periudhën 2012 - 2014, A.Ç për periudhën 2014 – 2018 dhe “****” për periudhën 2018 dhe në vazhdim. Lidhur me detyrimet tatimore për këtë pasuri, sqaron se vlerat e përcaktuara në kontratat e qirasë janë në vlerën neto, pra është vendosur vlerë neto me qëllim që qiramarrësi të paguajë detyrimet tatimore përkatëse si nga “****”, nga A.C person fizik dhe nga “****” shpk, ndërsa për njësitë me sip. 45 m², sip. 174

m2, dhe ullishte me sip. 3.000 m2, detyrimet tatimore janë paguar nga “****” dhe “****”, pavarësisht përcaktimeve të kontratave apo dispozitave të vendosura në këto kontrata. Pagesat për qiratë janë bërë pjesërisht cash dhe pjesa me e madhe e tyre nepërmjet bankës.

Me inventarin e datës 06.11.2023, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti paraqiti:

- Shkresë nga DRT Tiranë, datë 17.07.2023, për tatimin në burim të kontratave të qirave të lidhura ndër vite, ku bën me dije se nga verifikimi në sistem i deklaratave individuale të Rebani Jaupi, për vitin 2019 janë deklaruar të ardhura nga qiraja në vlerën 1.768.478 lekë, në vitin 2020 në vlerën 1.778.393 lekë, në vitin 2021 në vlerën 1.734.868 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 1.996.956 lekë.
- ✓ **Të ardhurat e subjektit nga pagat shpërblimet, etj., për periudhën 1991 - mars 2023 janë në vlerën totale rreth 21.560.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat nga qiraja të dokumentuara, për periudhën 2012 - mars 2023, janë në vlerën totale neto prej 59.497 euro (me bankë) + 7.718.000 lekë (sipas kontratave), konvertuar rreth 14.522.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me qiramarrësit e pasurive të paluajtshme, ku sipas kontratave të paraqitura, rezultojnë të jenë subjekte tregtare.**
- ✓ **DPT dhe DRT Tiranë konfirmojnë kontratat e qirasë me “****”, “****”, si pjesërisht pagesa tatimore qiraje nga kontrata me A.C Person Fizik dhe “****” shpk.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- ❖ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.
- 29. Shpenzime energji elektrike periudha janar - dhjetor 2022, adresa banesa në rrugën Medar Shtylla, shuma 175.477 lekë.
- 30. Shpenzime uji, periudha janar - dhjetor 2022, adresa banesa në rrugën Medar Shtylla, shuma 27.710 lekë.
- 31. Shpenzime interneti, periudha janar - prill 2022, me Albtelecom adresa banesa në rrugën Medar Shtylla, shuma 5.600 lekë.
- 32. Shpenzime interneti, periudha prill - dhjetor 2022, me Albtelecom, adresa banesa në rrugën Medar Shtylla, shuma 12.800 lekë.
- 33. Shpenzime për telefon Rebani Jaupi, nr. 0694135066, mbulohen nga DPPSH. Shuma 0 lekë.
- 34. Shpenzime për telefon Rebani Jaupi nr. 0672086366, shuma 18.000 lekë.
- 35. Shpenzime për telefon në emër të bashkëshortes Elvira Jaupi, me nr. 0692126366, shuma 14.400 lekë.
- 36. Shpenzime për telefon në emër të Kleard Jaupi me nr. 0672998436, shuma 15.600 lekë.
- 37. Shpenzime për telefon në emër të Ira Jaupi, me nr. 0675636213, shuma 15.600 lekë.

38. Kontratë në emër të shtetasit Rebani Jaupi, lidhur me FSHU për dyqan 100 m2, dhënë me qira, me adresë rruga Medar Shtylla, Tiranë, pagesat janë detyrim i qiramarrësit A.Ç. Shuma 0 lekë.
39. Kontratë në emër të shtetasit Rebani Jaupi, lidhur me UKT, për dyqan 100 m2, në bazë të kontratës së qirasë janë detyrim i qiramarrësit A.Ç. Shuma 0 lekë.
40. Kontratë në emër të shtetasit Rebani Jaupi, lidhur me FSHU për dyqanin 174 m2 dhe 45 m2 dhënë me qira, me adresë rruga Medar Shtylla, Tiranë. Pagesat janë detyrim i qiramarrësit “***”. Shuma 0 lekë.
41. Kontratë lidhur me UKT për dyqanin 174 m2 dhe 45 m2 dhënë me qira, me adresë rruga Medar Shtylla, Tiranë. Pagesat janë detyrim i qiramarrësit “***”. Shuma 0 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Librezë e OSHE, nr. ***, në emër të Rebani Jaupi, rruga Komuna Parisit, ku konfirmon për vitin 2022, pagesa në vlerën totale 206.622 lekë.
 - Nxjerrje nga sistemi i UKT, në lidhje me pagesat për pasurinë e ndodhur në rrugën Komuna e Parisit, ku rezulton se për vitin 2022 janë paguar në total 27.828 lekë.
 - Faturë tatimore shitje, për pagesë UKT nga Rebani Jaupi, për periudhën janar 2023.
 - Mandat arkëtimi UKT, bërë nga AK Invest (4 mandate), datë 31.12.2022, nga Rebani Jaupi, në vlerën 9.786 lekë. Kontrata nr. ***, Tiranë.
 - Kontratë me Albtelecom, datë 24.03.2020, me abonent Rebani Jaupi, për internet, me vlerë mujore 1.400 lekë në muaj, afati 24 mujor. Bashkëlidhur praktika.
 - Kontratë me Albtelecom, datë 13.04.2022, me abonent Rebani Jaupi, për internet, me vlerë mujore 1.600 lekë në muaj, afati 24 mujor, adresa rruga Medar Shtylla. Bashkëlidhur praktika.
 - Mandate arkëtimi nga FSHU (11 mandate), ku konstatohet se Rebani Jaupi, me kontratë nr. ***, ka arkëtuar për periudhën janar - dhjetor 2022, vlerën totale 497.468 lekë.
 - Shkresë në formë tabele, për pagesat e UKT, për njësi nr.3, rruga Komuna e Parisit në emër të Rebani Jaupi, ku për periudhën janar - dhjetor 2022, janë paguar në total 65.581 lekë.
 - Fatura tatimore nga UKT (2 fatura), ku konstatohet se klienti me kod ***, ka kryer pagesa, për muajin shkurt 2023.
 - Shkresa nga sistemi për Shërbim Furnizimi, për klientin Rebani Jaupi, me nr. *** dhe ***.
- 🚩 **FSHU**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.05.2023, konfirmon me gjeneralitetet Rebani Kaso Jaupi, 3 kontrata furnizimi, në instancën Tiranë dhe Rebani Jaupi, 1 kontratë furnizimi në instancën Tiranë, si më poshtë:
- Në instancën Tiranë, Selitë, nr. ***, shërbime furnizim, pagesa për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në vlerën totale 4.080 lekë.
 - Në instancën Selitë, Komuna e Parisit, nr. ***, shërbime furnizim, pagesat për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në vlerën totale 489.908 lekë.
 - Në instancën Tiranë, Selitë, nr. ***, shërbime furnizim, pagesat për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në vlerën totale 23.405 lekë.
 - Në instancën Selitë, Komuna e Parisit, nr. ***, familjar ap. nuk evidentohen pagesa të kryera.

- ✚ **UK Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 25.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, kontratë në adresën Komuna e Parisit, nr. ***, shuma e paguar për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 është në vlerën 27.828 lekë dhe nr. ***, shuma e paguar për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 është në vlerën 65.580 lekë. Bashkëlidhur dokument identifikimi i shtetasit Rebani Jaupi, si dhe certifikata e pasurisë, për pasurinë e llojit njësi, me sip. 100 m2, nr. ***, rruga Komuna e Parisit, Tiranë.
- ✚ **Vodafone Albania**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.06.2023, ka bashkëlidhur CD, ku konfirmon në emër të subjektit numrin ***, regjistruar në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.
- ✚ **One Albania sha**, me shkresën nr. *** prot, datë 07.06.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, numrin ***. Totali i pagesave të kryera për periudhën janar - dhjetor 2022, është në vlerën 18.283 lekë. Konfirmon kontratë interneti lidhur në vitin 2020, në vlerën 1.400 lekë në muaj.
- ✚ **14 Shoqëritë Rajonale të UK**, konfirmojnë se subjekti apo personat e lidhur, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.
- ✚ **Tring**, me shkresën nr. ***, datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.
- ✚ **Abissnet**, me shkresën nr. ***, datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.
- ✚ **Digicom**, me shkresën nr. ***, datë 12.05.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për shërbime interneti, për periudhën e kërkuar.
- Në **proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se për pagesën e dritave dhe të ujit, ai paguan vetëm për shtëpinë e banimit, ndërsa për njësitë, ato janë detyrime që paguhen nga qiramarrësit. Konkretisht për pagesën e dritave ka paraqitur librezën e OSHE, ku konfirmon pagesa për vitin 2022, rreth 206.000 lekë, ndërsa për pagesën e ujit, ka paraqitur dokumentacion përkatës nga UKT, ku konfirmohen pagesa për vitin 2022 rreth 27.000 lekë. Konstatimet e tjera në lidhje me dokumentacionin, si ato të paraqitura nga ana e tij edhe ato të konstatuara nga institucionet përkatëse, i përkasin njërive, për të cilat nuk ka detyrime për pagimin e dritave dhe ujit, pasi këto shpenzime paguhen nga qiramarrësit.
- ✓ **Shpenzimet për ujë, drita, telefoni, internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit, rezultojnë në total rreth 272.000 lekë.**
- ❖ Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur, jashtë territorit shqiptar gjatë tre viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022

42. Udhëtime jashtë shtetit për 3 (tre) vitet e fundit:

- Udhëtim jashtë shtetit kryer nga Rebani Jaupi në Maqedoni, nga data 04.05.2022 dhe kthim 06.05.2022 me shërbim pune. Shenzimet janë mbuluar nga pritësit (pala Maqedonase) dhe DPPSH. Shuma 0 lekë.
- Udhëtim jashtë shtetit, kryer nga Rebani Jaupi, Elvira Jaupi dhe Ira Jaupi, në Kosovë, në datën 04.06.2022 dhe kthim 05.06.2022. Shuma 250 euro.
- Udhëtim jashtë shtetit, në Janinë, Greqi, kryer nga Rebani, Elvira, Kleard dhe Ira Jaupi, datë 10.08.2022 dhe kthim 10.08.2022. Shuma 150 euro.
- Udhëtim jashtë shtetit në Dubai, kryer nga Kleard Jaupi, në datë 09.11.2022 dhe kthim 14.11.2022, shuma 1.600 euro.
- Udhëtim jashtë shtetit në Greqi, kryer nga Kleard Jaupi, datë 26.11.2022 dhe kthim 29.11.2022, shuma 150 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Raporti hyrje – dalje për shtetasin Rebani Jaupi, për periudhën 2005 - 2022. Për vitin 2022, rezultojnë tre hyrje, dy dalje me autoveturë.
- Raporti hyrje - dalje për shtetasen Elvira Jaupi, për periudhën 2015 - 2022. Për vitin 2022, rezulton një hyrje - dalje me autoveturë.
- Raporti hyrje - dalje për shtetasin Kleard Jaupi, për periudhën 2013 - 2022. Për periudhën 2020 - 2022, ka kryer 5 hyrje - dalje, 2 në Frankfurt, 2 me autoveturë dhe një në Dubai.
- Raporti hyrje - dalje për shtetasen Ira Jaupi, për periudhën 2015 - 2022. Në vitin 2022 rezulton, një hyrje - dalje me autoveturë.
- Urdhër nga DPPSH, nr. ***, datë 27.04.2022, për shërbim jashtë shtetit, ku është urdhëruar të shkojë me shërbim jashtë shtetit, për të marrë pjesë në Konferencën Rajonale të Drejtorëve të Shërbimeve Policore, që do të zhvillohet në Shkup, Maqedoni e Veriut, në datat 05 - 06 maj 2022, drejtuesi i lartë Rebani Jaupi dhe E.R. Datat e nisjes do të jenë 04 maj 2022 dhe kthimit 7 maj 2022. Të gjitha shpenzimet do të mbulohen nga organizatorët. Bashkëlidhur Urdhër nr. ***, datë 04.05.2022, për një ndryshim në urdhërin nr. ***, datë 27.04.2022, ku është vendosur zëvendësimi i drejtuesit E.R, me kryekomisar Sh.R.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se, në lidhje me shpenzimet e deklaruara si më sipër, ku sqaron se ka deklaruar shpenzimet në lidhje me lëvizjet e tij dhe familjarëve jashtë vendit. Nuk ka ruajtur fatura apo mandate në lidhje me shpenzimet e deklaruara si më sipër. Përsa i përket raportit të hyrje - daljeve të djalit Kleard Jaupi, sqaron se ka qënë në Germani në vitin 2020, për shkak të studimeve, sic e ka deklaruar tek shpenzimet për arsimimin e djalit.

Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka paraqitur:

- Raporti hyrje – dalje, për shtetasin Rebani Jaupi, për periudhën 2019 - 2023.
Konstatohen dalje në datë 04.05.2022 (pika kufitare Qafë Thanë) - hyrje datë 06.05.2022, (pika kufitare Morinë), dalje në datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë) – hyrje datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë). Gjithashtu, konstatohet një hyrje në datë 05.06.2022 nga (pika kufitare Morinë).
- Raport hyrje - dalje për shtetasen Elvira Jaupi, për periudhën 2019 - 2023.
Konstatohet dalje në datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë) - hyrje datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë).
- Raporti hyrje - dalje për shtetasin Kleard Jaupi, për periudhën 2020 - 2023.
Konstatohen dalje në datë 08.01.2020 (Rinas, Frankfurt) - hyrje datë 02.07.2020 (Rinas, Frankfurt), dalje në datë 09.07.2020 (Rinas, Frankfurt) - hyrje datë 20.08.2020 (Rinas, Frankfurt), dalje në datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë) - hyrje datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë), dalje në datë 09.11.2022 (Rinas, Fly Dubai) - hyrje datë 14.11.2022 (Rinas, Fly Dubai), dalje në datë 26.11.2022 (pika kufitare Kakavijë) - hyrje datë 29.11.2022 (pika kufitare Kakavijë).
- Raport hyrje - dalje për shtetasen Ira Jaupi, për periudhën 2022 - 2023.
Konstatohet dalje në datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë) - hyrje datë 10.08.2022 (pika kufitare Kakavijë).
- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me udhëtimet e konstatuara nga sistemi TIMS për të dhe familjarët e tij.**
- ✓ **Shpenzimet për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar, janë deklaruar në total rreth 2.150 euro, konvertuar rreth 245.000 lekë.**
- ❖ Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit:

43. Shpenzime arsimimi për fëmijët e subjektit të vlerësimit si më poshtë:

Arsimimi Kleard Jaupi

- Arsimin 9 vjeçar e ka kryer pranë shkollës publike Edith Durham, Tiranë, shuma 0 lekë.
- Arsimin e mesëm e ka kryer në shkollën jopublike Faik Konica, Tiranë, periudha 2016-2019, shuma 6.000 euro.
- Ka kryer kurs për studimin e gjuhës Gjermane në Marburg/ Gjermani, periudha 2019-2020, shuma 10.300 euro.
- Për te vazhduar studimet në Gjermani, i është dërguar shuma prej 8.500 euro, por meqenëse nuk e ka vazhduar shkollimin, ka të arkëtuar shumën prej 6.744 euro, me diferencë shumën prej 1.756 euro.
- Arsimin e lartë në universitetin privat Epoka, periudha 2020-2023, pagesa vjetore 2.500 euro në vit, në total 7.500 euro.

Arsimimi Ira Jaupi

- Arsimin 9 vjeçar e ka kryer pranë shkollës publike Edith Durham, Tiranë, shuma 0 lekë.
- Arsimin e mesëm e ka kryer në shkollën jopublike New York High School, ku ka qënë me kontratë për përfitimin e bursës për 3 vitet e shkollimit dhe është paguar vetëm transporti në shumën 400 euro në vit, në total 1.200 euro.
- Ka kryer kurs për studimin e gjuhës së huaj në shkollën London Language Institute, periudha nëntor 2016 – qershor 2019, shuma 143.220 lekë.
- Ka filluar arsimin e lartë në Universitetin New York, Tiranë, periudha 2022-2023, shuma 2.418 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë datë 12.09.2016, me palë Shkolla 12 vjeçare jopublike "Faik Konica" dhe shtetasi Kleard Jaupi, për vitin shkollor 2016 - 2017, në vlerën totale 2.000 euro.
- Kontratë date 15.09.2017, me palë Shkolla 12 vjeçare jopublike "Faik Konica" dhe shtetasi Kleard Jaupi, për vitin shkollor 2018 - 2019, në vlerën totale 2.000 euro.
- Kontratë datë 18.09.2018, me palë Shkolla 12 vjeçare jopublike "Faik Konica" dhe shtetasi Kleard Jaupi, për vitin shkollor 2019 - 2020, në vlerën totale 2.000 euro.
- Mandate arkëtimi (3 mandate), për pagesa shkollimi nga Rebani Jaupi, për shkollën Faik Konica, për periudhën 2016 - 2019, në vlerën totale 6.000 euro, për nxënësin Kleard Jaupi.
- Kontrate shërbimi, datë 30.09.2020, me palë Universitetin Epoka dhe studentin Kleard Jaupi, për të ndjekur programin e studimit 3 vjeçar, gjatë viteve akademike 2020 - 2023, në vlerën vjetore prej 2.500 euro.
- Vërtetim nga Universiteti Epoka, datë 02.03.2023, që vërteton se Kleard Jaupi, për vitet akademike 2019 - 2023, ka kryer pagesa në vlerën totale 7.360 euro.
- Mandate pagesash nga ISP Bank, (pjesërisht të qarta), për pagesat shkollore të Kleard Jaupi, për periudhën 2021 - 2022.
- Deklaratë nga Kleard Jaupi, datë 30.09.2020, i cili autorizon Universitetin Epoka, për trajtimin e të dhënave personale.
- Dokument mbi performancën, në formë tabelle, i Universitetit Epoka.
- Fatura tatimore shitje, nga Turgut Ozal Education, Universiteti Epoka, për pagesë nga Kleard Jaupi, për vitin shkollor 2020 - 2021, në vlerën 180.235 lekë.
- Mandat arkëtimi nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, për maturë shtetërore nga Kleard Jaupi, në vlerën 2.050 lekë.
- Kthim përgjigje nga London Language Institute, datë 11.07.2019, ku bën me dije se nxënësjja Ira Jaupi, për periudhën nëntor 2016 - qershor 2019, ka kryer pagesa në vlerën totale 143.220 lekë.
- Kontratë datë 02.09.2022, me palë University of New York Tiranë dhe Ira Jaupi, për kryerjen e studimeve pranë këtij Universiteti, për periudhën akademike 2022 - 2023, në vlerën 3.600 euro për vit akademik dhe kohëzgjatja e studimit është tre vjet. Bashkëlidhur praktika.
- Urdhër transfertë nga Credins Bank, datë 26.08.2022, ku Rebani Jaupi, paguan vlerën 2.418 euro, për UNYT, me përshkrimin "pagesa administrative", për Ira Jaupi.

- Transfertë bankare nga Credins Bank, datë 06.03.2023, ku konstatohet se Rebani Jaupi transferon në favor të Epoka University, në vlerën 1.250 euro, me përshkrimin "School payment for Klear Jaupi".
 - Nxjerrje llogarie nga ISP Bank, datë 18.03.2021, për llogari në euro në emër të Klear Jaupi, ku evidentohen kreditime (automatike prej 853 euro në muaj, për 8 muaj), për periudhën 03.01.2020 - 03.08.2020, në vlerën totale 6.824 euro dhe transfertë për periudhën 30.10.2020 - 09.12.2020, në favor të SPK Marburg-Biedenkopf, në vlerën totale 4.506 euro.
 - Mandat pagese nga ISP Bank, ku konstatohet se Klear Jaupi, ka kryer pagesë në vlerën 500 lekë, në datë 18.03.2021, komision për lëvizjet e llogarisë.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari rrjedhëse në euro, ku konfirmon transferimin e vlerës 2.418 euro, në datën 26.08.2022, në favor të UNYT, me përshkrimin "Pagesë administrative dhe totale Ira Jaupi". Konfirmon transferimin e vlerës 1.250 euro, në datën 06.03.2023, në favor të Turgut Ozal Education (Epoka U), me përshkrimin "School payment Klear Jaupi". Konfirmon transferimin e vlerës 8.500 euro, në datë 21.05.2020, në llogari të Klear Jaupi me përshkrimin "Transfer from father for school and living expenses"
- ✚ **ISP Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon në emër të Klear Jaupi, llogari rrjedhëse në euro, ku konfirmohet kreditimi i vlerës 10.240 euro në datën 24.07.2019, me përshkrimin "Kursime familjare nga puna e prindërve dhe qiraja e dyqaneve". Për periudhën 02.09.2019 deri më 03.08.2020, transferon në një llogari tjetër në euro, në total 10.236 euro (12 transfertë në vlerën 853 euro secila). Konfirmon transferimin e vlerës 1.250 euro, në datën 12.03.2021, në favor të Fakulteti Epoka, Klear Jaupi.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se, në lidhje me shpenzimet për kursin e djalit në Gjermani, për periudhën 2019 - 2020, i ka dhënë djalit vlerën 10.240 euro, të cilat i ka kredituar në llogarinë e tij pranë Intesa Sanpaolo Bank, si dhe ka transferuar vlerën 8.500 euro, nga llogaria e tij në Credins Bank për shpenzime shkollimi dhe jetese në Gjermani. Sqaron se pagesat e kursit të studimit të djalit në Gjermani, përfshirë dhe ato të jetesës kanë qënë në total në vlerën rreth 12.000 euro, për të cilat nuk ka ruajtur mandatet e pagesës së shkolles, apo dokumentacion në lidhje me këto shpenzime.
 - ✓ **Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 143.220 lekë + 29.174 euro, konvertuar rreth 3.471.000 lekë.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - ELVIRA JAUPI

DEKLARIMI I PASURIVE

44. Apartament, regjistruar në datë 10.01.2019, nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, ZVRPP Tiranë, me sip. 230 m2. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, me nr. ***, datë 24.12.2008, jam trashëgimtare ligjore e rradhës së parë e të ndjerit babait tim Bekim Hoxha, së bashku me nënën A.H dhe vëllain G.H, ku trashëgojmë secili 1/3 pjesë të këtij apartmenti. Shuma 0 lekë. Zotëron 33 %.

✚ **ASHK Tiranë - DV Tirana Rurale 1, DV Tiranë Rurale 2, DV Tirana Veri, DV Tirana Jug**, me shkresat nr. *** prot., datë 23.06.2023, datë 07.07.2023, datë 03.07.2023, si dhe datë 26.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të bashkëshortes Elvira Jaupi.

✚ **ASHK Online**, konfirmon pasurinë me nr. ***, zk. ***, në emër të G.H, Elvira Jaupi dhe A.H.

Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

➤ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 24.12.2008, me kërkues G.H, me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të trashëgimlënësit B.H, ku është vendosur lëshimi i trashëgimisë, duke përcaktuar si trashëgimtarë A.H, Elvira Hoxha (Jaupi) dhe G.H, të cilët trashëgojnë secili nga 1/3 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

➤ Certifikatë pronësie, datë 10.01.2019, për pasurinë e llojit apartment, me nr. ***, zk. ***, me sip. 230 m2, e ndodhur në Tiranë, në emër të A.H, Elvira Jaupi dhe G.H, me nga 1/3 pjesë takuese secili.

✓ **ASHK online konfirmon apartamentin e deklaruar nga bashkëshortja, përfituar me dëshmi trashëgimie.**

45. Gjëndje në llogarinë bankare në ABI Bank, deri në datë 07.03.2023, burimi nga pagat, shuma 138.394 lekë. Zotëron 100 %.

✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Elvira Jaupi, llogari në lekë, me gjëndje në datë 10.03.2023, në vlerën 98.394 lekë.

✓ **ABI Bank, konfirmon llogarinë me gjëndje 98.394 lekë, në datën 10.03.2023.**

46. Gjëndje cash jashtë sistemit bankar, me burim të ardhura nga paga, kursimet familjare, shuma 600.000 lekë. Zotëron 50 %.

✓ **Trajtuar më sipër.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

47. Të ardhura nga fitimi i akumuluar tek shoqëria Kelvinator shpk, Nipt. ***, periudha 1998 - 2002, shuma 3.375.443 lekë.

48. Të ardhura nga paga, pranë kompanisë Dejani shpk, për periudhën janar 2003 – shtator 2006, shuma 500.992 lekë.
49. Të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, profili mësues i ciklit të ulët, aktualisht në shkollën Konferenca e Pezës, periudha nëntor 2009 - shkurt 2023, shuma 6.668.258 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, datë 10.07.2019, që vërteton pagat mbi të cilat është derdhur kontribut, të Elvira Jaupi, nga subjekti Kelvinator shpk, për periudhën prill 1998 - dhjetor 2002, në vlerën totale rreth 366.780 lekë.
 - Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, datë 05.10.2020, që vërteton pagat bruto të Elvira Jaupi, për periudhën janar 2003 – janar 2007, nga subjekti Dejani shpk, në vlerën totale rreth 486.000 lekë.
 - Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, datë 05.10.2020, që vërteton pagat bruto të Elvira Jaupi, për periudhën shtator 2007 – maj 2009, dhe korrik 2011 - dhjetor 2011, nga subjekti Edmeli shpk, në vlerën totale rreth 447.045 lekë.
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, që vërteton pagat neto të Elvira Jaupi, për periudhën 01.10.2010 - 31.08.2020, në vlerën totale 4.807.308 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga RFZ Bank, datë 29.09.2020, për llogari në lekë, në emër të Elvira Jaupi, për periudhën 30.10.2009 deri më datë 16.01.2017.
 - Nxjerrje llogarie nga ABI Bank, datë 07.03.2023, për llogari në lekë, në emër të Elvira Jaupi, për periudhën 01.01.2021 deri më datë 07.03.2023.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, ku konfirmon në emër të Elvira Jaupi, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe shpërblime, për periudhën 16.12.2009 deri me 08.04.2014, në vlerën totale 1.805.377 lekë.
- ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon në emër të Elvira Jaupi, llogari në lekë, ku konfirmohet transferim page në datë 12.09.2007, në vlerën 14.396 lekë, transferim page në datë 19.08.2008 nga Edmeli, në vlerën 151.157 lekë, dhe Dejani, në vlerën 7.197 lekë, transferim page nga Edmeli më datë 09.12.2009, në vlerën 144.748 lekë.
- ✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. *** prot, date 08.05.2023, konfirmon në emër të Elvira Jaupi, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga për periudhën 06.05.2014 deri më 03.03.2023, në vlerën totale 4.700.093 lekë.
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasja Elvira Jaupi, rezulton e regjistruar si administratore e subjektit Kelvinator, me Nipt. ***, e regjistruar në vitin 1998. Aktualisht ky subjekt rezulton me status pasiv nga viti 2004. Nga verifikimet ky subjekt nuk ka dosje.

Janë administruar:

- Pasqyrat financiare të shoqërisë Kelvinator shpk, ku konfirmon fitimin neto për vitet përkatëse si më poshte:
 - për vitin 1998, në vlerën 353.711 lekë;
 - për vitin 1999, në vlerën 268.206 lekë;
 - për vitin 2000, në vlerën 895.770 lekë;
 - për vitin 2001, në vlerën 1.752.670 lekë;
 - për vitin 2002, në vlerën 111.165 lekë.
 - Fitimi neto për periudhën 1998 - 2002, rezulton në vlerën totale 3.381.522 lekë.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 28.04.2000, ku citohet ndër të tjera se “shoqëria Kelvinator, është regjistruar me Vendim Gjykate nr. ***, datë 27.03.1998, me ortake të vetme dhe administratore shtetasen E.H”.
- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes, nga pagat, për periudhën 1998 - mars 2023, rezultojnë në vlerën neto rreth 7.545.000 lekë.**
- ✓ **Fitimi nga biznesi për periudhën 1998 - 2002, rezulton në vlerën 3.381.000 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT - KLEARD JAUPI

DEKLARIMI I PASURIVE

50. Llogari rrjedhëse në bankën Sparkasse Marburg-Biedenkopf. Kjo llogari është krijuar në vitin 2019, në momentin që unë kam filluar studimet në Gjermani, me qëllim për të përmbushur të gjitha detyrimet financiare. Burimi, të ardhura nga prindërit, aktualisht deri në datë 10.03.2023, gjëndja është 6.744 euro. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga ISP Bank, datë 18.03.2021, për llogari në euro në emër të Kleard Jaupi, ku evidentohen transfertat për periudhën 30.10.2020 - 09.12.2020, në favor të SPK Marburg-Biedenkopf, në vlerën totale 4.506 euro.

Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Statement nga Sparkasse Marburg-Biedenkopf (e përkthyer zyrtarisht në gjuhën Shqipe), për llogari në euro në emër të Kleard Jaupi, ku rezulton se gjëndja e llogarisë në datë 31.03.2023, është në vlerën 6.741 euro.
- ✓ **Gjendja e llogarisë së Kleard Jaupi, në bankën Sparkasse Marburg-Biedenkopf, Gjermani, në datën 31.03.2023, konfirmohet në vlerën 6.741 euro.**

51. Llogari bankare në Credins Bank, krijuar në vitin 2022, me burim të ardhura nga prindërit, shuma 48.71 euro. Zotëron 100 %.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Kleard Jaupi, llogari në euro, me gjëndje në datë 10.03.2023, në vlerën 48 euro.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Credins Bank.**

HETIMI ADMINISTRATIV

✚ **Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Pro Credit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, RFZ Invest, Credins Invest, Easypay, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Iutecredit Albania, Kredo Finance**, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre, çka përputhet me deklarinin.

✚ **Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Kurbin, Shkodër, Vlorë, Korçë, Lezhë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Kamëz-Vorë, Lushnje, Kuçovë, Malësi e Madhe, Gramsh, Kavajë, Elbasan, Kolonjë, Has, Skrapar, Kukës, Durrës, Tropojë, Bulqizë, Pukë, Peqin, Mirditë, Tepelenë, Përmet, Krujë; Devoll, Zonat e Stimuluara, Librazhd, Mat, Dibër, Mallakastër**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në euro, lekë dhe USD, në emër të shtetasës Elvira A. Jaupi.

✓ **Rezulton se shtetasja Elvira A. Jaupi, nuk është bashkëshortia e subjektit, me generalitete Elvira B. Jaupi.**

✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Rebani Jaupi, llogari në euro, e cila rezulton e mbyllur në vitin 2022.

✚ **Unioni Financiar Tiranë**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon në emër të Kleard Jaupi, një transaksion dërgesë, në vlerën 10.000 lekë.

✚ **AK Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, konfirmon në emër të Elvira Jaupi, një transaksion si përfituese në vlerën 100 USD, nga A.Z.

✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Rebani Jaupi apo personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon të regjistruar shtetasen A.H, si person fizik, me Nipt. ***, në DRT Gjirokastrë, nga viti 2003.
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot., datë 17.05.2023, bën me dije se për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar, nuk mund të konfirmojnë periudha kontributive apo paga mbi të cilën këta subjekte janë siguruar, nëse nuk jepet dokumentacioni lidhur me emërtimin e qendrës së punës, Nipt-in e subjektit, fotokopje e librezës së punës.
- ✚ **ISSH, Drejtoria Juridike**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, i dërgon shkresë Drejtorisë së Arkivit Qëndror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën *** prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit, apo personave të lidhur.
- ❖ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;
 - Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 10.03.2023, është deklaruar bruto/neto 25.546.194 lekë + 54.089 Euro, e konvertuar rreth 34.716.000 lekë. (Pasuritë janë llogaritur sipas vlerave të kontratave. Për diferencën ndërmjet çmimit të paguar dhe çmimit të kontratave, në shumën totale rreth 11.742.000 lekë, sipas shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur, vëllëzërit e subjektit nuk kanë pretendime).
 - Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblime, etj., për periudhën 1991 - mars 2023, janë në vlerën totale rreth 21.560.000 lekë.
 - Të ardhurat neto nga qiraja e njëjësive, të dokumentuara, për periudhën 2012 - mars 2023, janë në vlerën totale 59.497 euro + 7.718.000 lekë, konvertuar rreth 14.522.000 lekë.
 - Të ardhurat neto të bashkëshortes nga paga, shpërblime, etj., për periudhën 1998 - mars 2023, janë në vlerën neto rreth 7.545.000 lekë.
 - Fitimi neto nga aktiviteti privat i bashkëshortes, për periudhën 1998 - 2002, rezulton në vlerën 3.381.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar dhe përdorur si burim:

- Dhurim nga mamaja e bashkëshortes, në vitin 2007, në vlerën 50.000 Usd, konvertuar rreth 5.400.000 lekë.


- Kredi në shumën 20.000 Euro, marrë në Tirana Bank, në vitin 2007, për rikonstrukcion të dy njësave, në Selitë, Tiranë (e shlyer me burim nga të ardhurat familjare dhe qiratë e njësave).
- Diferenca në shumën rreth 11.742.000 lekë, midis vlerës së kontratave dhe asaj të likuiduar, për blerjen e tre njësave në Tiranë, e rregulluar me marrëveshje midis subjektit dhe vëllezërve.
- Për periudhën 2000 - mars 2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 15.100.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon, internet etj, në total rreth 272.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime, private, personale dhe të personave të lidhur, jashtë territorit shqiptar, në vlerën totale 2.150 euro, konvertuar rreth 245.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e fëmijëve, në total rreth 143.220 lekë + 29.174 euro, konvertuar rreth 3.471.000 lekë.
- Subjekti ka deklaruar shpenzime për punime të brendshme dhe arredim në pasuritë e deklaruara, në shumën totale rreth 20.000 Euro + 1.600.000 lekë, konvertuar rreth 3.880.000 lekë.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Rebani Kaso Jaupi:

- ✓ **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interes**

B. KONTROLLI I FIGURËS

-  Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarameve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarameve, si dhe

identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Rebani Jaupi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës” të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit Z. Rebani Jaupi, në zbatim të nenit 36, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- b. Raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 03.10.2023, të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ **Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 03.10.2023, ku ka konstatuar se:

a) **Subjekti i vlerësimit z. Rebani Kaso Jaupi, me detyrë Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk ka pasur emër dhe mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër dhe mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar.
- Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.

- Nuk ka qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale
- Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk ka marrë ndonjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes suaj është përfshirë/dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka dijeni që një nga anëtarët e familjes ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka pasur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqtrajtuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së infomacionit të klasifikuar si dhe as tentuar apo kryer aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qënë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

Subjekti ka nënshkruar dy vetëdeklarime për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje te neneve 35 – 42, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse dhe raportit nga Drejtoria e

Analizës dhe Sigurisë së Personelit, ka kryer hetimin mbi kontrollin e figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit, **nga ku konstatoi se:**

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën nr. *** prot. datë 09.06.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. *** prot. datë 19.05.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit Z. Jaupi, nuk rezulton i dënuar.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 25.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, ka një të dhënë por nuk është e konfirmuar sipas përcaktimeve të nenit 39, pika 1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023 dhe me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e tij në aktivitete e tij në aktivitete të kundërligjshme.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 31.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, nuk figurojnë informacione të regjistruara për veprimtari kriminale.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën e datën 13.06.2023, shkresën nr. *** prot. datë 21.06.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 17.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm dhe nuk ka procedime penale të referuara.
- ✚ **Institucionet ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 27.06.2023, shkresën nr. *** prot. datë 17.05.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 08.06.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi nuk është nxjerrë urdhër ndalimi, nuk është kërkuar masë e sigurimit personal (masa shtrënguese/masa parandaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- ✚ **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr. *** prot. datë 25.05.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Jaupi, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar me datë 03.05.2023, e vlefshme deri më datë 02.05.2028. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- ✚ **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. *** prot. datë 08.06.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Jaupi, nuk ka qënë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

✚ **Në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, për subjektin e vlerësimit Z. Jaupi, nuk ka denoncime nga publiku dhe nuk disponohen ankesa për të.

✚ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë, ka kryer në datën 09.01.2024, testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga Ekzaminimi Toksikologjiko – Ligjor, për përdorim lëndësh narkotike, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nr. *** datë 11.01.2024, konkludohet se subjekti vlerësimit **Z. Rebani Kaso Jaupi**,

➤ **Akualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.**

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Rebani Kaso Jaupi:

✓ ***Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***

✓ ***Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar
- ✚ Subjekti i vlerësimit Z. Rebani Jaupi më datë 10.03.2023, ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- ✚ Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “Periodha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet” dhe “Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban , periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës”.
- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z. Rebani Jaupi** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- ✚ Struktura e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e vlerësimi profesional, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 30.06.2023, ku në konkluzionin përfundimtar, shprehet se:
- a) **“Punonjësi i policisë z. Rebani Kaso Jaupi është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, ka kryer hetimin e plotë mbi aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, **nga ku është konstatuar si më poshtë:**

1. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma a, e Ligjit 12/2018, të ndryshuar.

❖ Në Formularin e Aftësive Profesionale të plotësuar nga subjekti ka rezultuar se ka kryer studimet si më poshtë:

➤ 1986 – 1990 – Shkollën e Lartë, të Ministrisë së Brendshme, sistemi 4 – vjeçar.

✚ Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit ka rezultuar:

▪ Kopje e Diplomës së Shkollës së Lartë “Dega Polici” në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme.

✓ Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti i vlerësimit, për periudhën e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, sipas ecurisë së tij në karrierë, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar në vite dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

2. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, përcaktohet se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet”.

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është ecuria në karrierë dhe fitimi i gradave, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

✚ Subjekti i vlerësimit Rebani Jaupi, ka një karrierë në Policisë e Shtetit prej 25 vitesh e 5 muaj. Në formularin e aftësive profesionale, plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit, subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

➤ Nga data 18.11.2015 deri më 15.02.2018, ka kryer detyrën e Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

➤ Nga data 16.02.2018 deri më 29.05.2019, ka kryer detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- Nga 30.05.2019 deri më 18.10.2021, ka kryer detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.
- Nga data 19.10.2021 dhe aktualisht, ka kryer detyrën e Drejtorit të Departamentit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- ✚ Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:
 - **Grada Drejtues i Lartë** sipas urdhrit nr. ***, datë 17.11.2015, “Për emërimin në detyrë dhe dhënien e gradës policore Drejtues i Lartë, të një punonjësi policie”, nga Ministri i Brendshëm.
 - **Grada Drejtues i Parë** sipas urdhrit nr. ***, datë 15.02.2018, “Për dhënien e gradës policore dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - **Grada Drejtues i Lartë** sipas urdhrit nr. ***, datë 21.10.2021, “Për zbatimin e urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. ***, datë 20.10.2021, Për emërimin në detyrë dhe dhënien e gradës policore Drejtues i Lartë, të një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- ✓ **Pas kontrollit dhe verifikimit me dokumentacionin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Rebani Jaupi, arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

3. Vlerësimet e punës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësimet e punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit për periudhën 2018 – 2022, janë administruar 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës. Nga administrimi i këtyre akteve, rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës me vlerësimin “**Shumë Mirë**”.

Vlerësimet përkatëse si vijon:

▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	98 Pikë	(shumë mirë)

- ✚ Avokati i Popullit, me shkresën nr. *** prot. datë 30.05.2023, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Rebani Jaupi.
- ✚ Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime apo ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- ✓ **Bazuar në vlerësimet e sipërmendura, të administruara në dosjen personale të subjektit, arrihet në konkluzionin se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale dhe funksionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

4. Respektimi i rregullave të etikës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë masat disiplinore, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma d, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Nga verifikimi në dosjen personale dhe sistemin RMIS, rezultoi se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, (2018 - 2023), subjekti i vlerësimit Z. Rebani Jaupi, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes personale, bazuar në vlerësimet e aftësive individuale të punës nga eprorët ndër vite, në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, ka rezultuar se: subjekti shfaq integritet dhe standarde të larta etike, është shembull i mirë për organizatën.

- ✓ **Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

5. Kualifikimet dhe trajnimet:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë certifikatat e trajnimeve dhe medaljet, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Nga verifikimi dosjes personale si dhe pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, si më poshtë:

- Trajnim në vitin 2017, Për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”;
- Trajnim në vitin 2017, Për pjesëmarrjen në seminarin “Perspektiva gjinore në policim”;
- Trajnim në vitin 2019, Për sigurinë e personelit;
- Trajnim në vitin 2020, Ka marrë pjesë në trajnimin “Shërbimi Diplomantik i Sigurisë”

Megjithëse kryesisht trajnimet e kryera nga subjekti nuk janë të gjitha në periudhën sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ato gjithsesi janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

Konstatohet se:

Trajnimet dhe pajisja me çertifikata trajnimi është kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i strukturës dhe se ato janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

✓ **Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

6. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, botime.

✚ Subjekti i vlerësimit Z. Rehani Jaupi, në Formularin e Aftësive Profesionale, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, është angazhuar si vijon:

- Në konferencat shkencore, veçanërisht ato të zhvilluara nga Akademia e Sigurisë:
- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare – “Kontributi në Sigurinë Publike nëpërmjet Arsimimit”, nëntor 2016.
- Konferenca Shkencore Kombëtare – “Depresioni dhe Vetëvrasja”, prill 2017.
- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare – “Shkencat Ligjore dhe Sfidat Bashkëkohore të Sigurisë”, nëntor 2017, të organizuara nga Ministria e Brendshme për prezantimin e Projektligjit, “Për vlerësimin kalimtar të punonjësve të policisë, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, zhvilluar me shoqërinë civile, me përfaqësuesit e huaj në Shqipëri, të zhvilluara gjatë vitit 2018.

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Rehani Kaso Jaupi:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLuzioni Përfundimtar:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Rebani Kaso Jaupi, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Rebani Kaso Jaupi**, me funksion Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 15.04.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesues

Denisa SINA

Relator

Suela BULKU

Anëtar

Arben SEFAJ